

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.1/2, Janar - Shkurt 2021

E MËRKURA E PËRHIME

”Kujtoju o njeri se pluhur je dhe në pluhur do të kthehesh”



E Mërkura e Përhime i referohet në mënyrë të veçantë ritit liturgjik që karakterizon në mënyrë zyrtare ditën e parë të kohës së Kreshmëve. Gjatë meshës meshtari kremtues menjëherë mbas predikimit shpërndan mbi kokat ose ballin e besimtarëve hirin e bekuar për t'ju kujtuar kthimin dhe për t'i nxitur ata në angazhimin pendestar. Koha e Kreshmëve zgjatë 40 ditë deri në solemnitetin e Pashkëve. Numri 40 është simbolik dhe tregon 40 ditët që Jezusi kaloi në shkretëtirë pas pagëzimit në Jordan, para fillimit të predikimit të tij. Në ato 40 ditë, birit të Zotit iu desh të pendohej dhe të agjëronte dhe të kapërcente çdo lloj tundimi që i ofroi djalli.

Sipas traditës Katolike gjatë kësaj dite nuk mund të konsumohen ushqime që ken si bazë mishin, po ashtu edhe çdo të premte para kohës së Pashkëve. Veshja liturgjike është ajo e ngjyrës vjollcë, sepse paraqet kohën e pendesës. Për herë të parë ceremonia e të Mërkurës së përhime u praktikua në shekullin e VI pas Krishtit. Në fillim Riti i Përhimes ishte i rezervuar vetëm atyre që ishin të penduar ose “të penduarit”, e cila shënonte fillimin e ecjes së tyre drejt zgjidhjes së mëkateve që

do t'ju jepej atyre të enjten e madhe në mëngjes. Më vonë, duke u hequr pendesa publike ky riti u shtri për të gjithë besimtarët për të kujtuar mbarimin e jetës së çdo njeriu të shkaktuar nga mëkati origjinal. Në ditë e mërkurës prifti e bekon hirin nga i vjen edhe emri (Mërkura e përhimt), bekimi bëhet gjatë liturgjisë apo meshës i përhi besimtarët duke i përkujtuar :”Kujtoju o njeri se pluhur je dhe në pluhur do të kthehesh” (lat: Memento homo, quia pulvis es, et in pulverem reverteris) Zan 3,19, ose “Kthehuni e besoni Ungjillit” (Mk 1,15).

Tradicionalisht, gjatë të Mërkurës së Përhime, duhet të agjërohet siç ndodh edhe të Premten e Madhe. Qëllimi i agjërit, sipas traditës së krishterë, do të përfaqësonte forcën e njeriut për të mposhtur pasionet tokësore. Marrja e hirit shënon edhe një kohë pendese, kthimi dhe meditimi të Fjalës së Zotit.

Mërkura e përhime lëviz sipas Pashkëve, më së hershmit bie me 4 shkurt dhe më së vonit më 22 mars.

Don Kristjan Marku



Papa Françesku KOHA E KRESHMËS	4
Papa Françesku MARRËDHËNIA E BESIMIT	6
Imzot Angelo Massafra O.F.M. KULTURA E PËRKUJDESJES SI RRUGËTIM PAQEJE	8
Dom Artur Jaku NATYRA KA KRIJUAR NJË TË DREJTË PËR TË GJITHË	9
Imzot Angelo Massafra O.F.M. KEMI SHUMË PËR TË REFLEKTUAR	11
Dom Gjovalin Simoni NATYRA MË E THELLË E KISHËS	13
Moter Marjeta Gjoka "SHEN JOZEFI", NJË SHENJT PËR TU RIZBULUAR	16
Don Nosh Gjollaj CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS	20
Luigi Territo S.I. TË JETOSH NË TË MUNDSHMEN	22
Redaksia ORIENTIMET PASTORALE MBI TRAFIKIMIN	25
Luigj Mila ZHVILLIMI TËRËSOR NJERËZOR	27
Fr. Landi Jaku OFM DO TË ANGAZHOHEMI NË VEPRA	28
Don Raffaele Gagliardi GJITHMONË I GATSHËM PËR TË NDIHMUAR	30
Redaksia KUVENDIT KISHTAR TË ARBËNIT	31

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIV, nr. 1/2 (539 - 540) Janar - Shkurt 2021

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

KOHA E KRESHMËS: KOHË PËR TË RIPËRTËRIRË FENË, SHPRESËN DHE DASHURINË

*Papa Françesko për Kreshmën 2021
“Ja, po ngjitemi në Jerusalem...” (Mt 20,18).*

Të dashur vëllezër e motra,
duke u treguar nxënësve të vet për mundimet, vdekjen dhe ngjalljen e vet, për plotësimin e vullnesës së Atit, Jezusi u zbulon atyre domethënien e thellë të misionit të vet dhe i thërret që t'i bashkëngjiten këtij misioni, për shpëtimin e botës.

Duke përshkuar rrugëtimin kreshmor, që na çon drejt kremtimeve pashkore, kujtojmë se Ai «e përuli vetveten duke u bërë i dëgjueshëm deri në vdekje, mu deri në vdekjen në kryq» (Fil 2,8). Në këtë kohë kthimi ripërtërijmë *fenë tonë*, marrim “*ujin e gjallë*” të shpresës dhe marrim me zemër të hapur *dashurinë e Hyjit*, që na shndërron në vëllezër dhe motra në Krishtin. Natën e Pashkës ripërtërijmë premtimet e Pagëzimit tonë, për të rilindur si burra të rinj dhe gra të reja, falë veprës së Shpirtit Shenjt. Itinerari i Kreshmës, ashtu si krejt ecja e krishterë, përshkohet krejtësisht nën dritën e Ngjalljes, që gjallëron ndjenjat, qëndrimet dhe zgjedhjet e atij që dëshiron ta ndjekë Krishtin.

Agjërimi, lutja dhe lëmosha, siç paraqiten prej Jezusit në predikimin e tij (krh. Mt 6,1-18), janë kushtet dhe shprehja e kthimit tonë. Udhë e varfërisë dhe e privimit (*agjërimi*), shikimi dhe gjestet e dashurisë për njeriun e plagosur (*lëmosha*) dhe dialogu birnor me Atin (*lutja*) na mundësojnë që të mishërojmë një fe të sinqertë, një shpresë të gjallë dhe një dashuri vepruese.

1. Feja na thërret që ta pranojmë të Vërtetën dhe të bëhemi dëshmitarë, përpara Hyjit dhe përpara vëllezërve e motrave

Në këtë Kreshmë, *pranimi dhe jetimi i të Vërtetës së shfaqur në Krishtin* do të thotë para së gjithash ta lëmë veten që të arrihemi prej Fjalës së Hyjit, që na përçohet, brezni më brezni, prej Kishës. Kjo e Vërtetë nuk është pjellë e trurit, vetëm për pak mendje të zgjedhura, superiore apo të ndritura, por është një mesazh që marrim dhe që mund ta kuptojmë falë inteligjencës së zemrës, që i është hapur madhësisë së Hyjit që na do përpara se ne vetë të bëhemi të vetëdijshëm për një gjë të tillë. Kjo e Vërtetë është vetë Krishti, që duke marrë deri në fund njerëzinë tonë është bërë Udhë – kërkuese, por e hapur për të gjithë – që na çon në plotësinë e Jetës.

Agjërimi i jetuar si një përvojë privimi i çon të gjithë ata që e jetojnë atë në thjeshtësinë e zemrës të zbulojnë dhuratën e Hyjit dhe të kuptojnë realitetin



tonë si krijesa të bëra në shëmbëlltyrë dhe përngjasim të Tij, që në Të të gjejmë plotësinë. Duke bërë përvojën e një varfërie të pranuar, ai që agjëron bëhet i varfër me të varfrit dhe “grumbullon” pasurinë e dashurisë që ka marrë dhe që bashkëndon. I kuptuar dhe i praktikuar në këtë mënyrë, agjërimi na ndihmon që ta duam Hyjit dhe të afërmin meqë, siç mëson edhe Shën Tomë Akui, dashuria është një lëvizje që e përqendron vëmendjen tek tjetri duke e konsideruar atë si një gjë të vetme me vetveten (krh. Enciklika *Fratelli tutti* [FT], 93).

Koha e Kreshmës është një kohë për të besuar apo për ta marrë Hyjin në jetën tonë dhe për t'i lejuar Atij që “të banojë” në ne (krh. Gjn 14,23). Të agërojmë do të thotë ta lirojmë ekzistencën tonë prej gjithçkaje që na pengon, edhe prej ngopjes me informacion – të vërtetë apo të rremë – dhe prej produkteve të konsumit, për t'ia hapur dyert e zemrës sonë Atij që vjen për ne i varfër në gjithçka, por «plot hir e të vërtetë» (Gjn 1,14): Birit të Hyjit Shpëtimtar.

2. Shpresa si “ujë i gjallë”, që na mundëson të vazhdojmë ecjen tonë

Samaritania, të cilës Jezusi i kërkon ujë për të pirë pranë pusit, nuk kupton kur Ai i thotë se mund t'i japë “ujë të gjallë” (Gjn 4,10). Në fillim ajo mendon me të drejtë për ujin material, ndërsa Jezusi i referohet Shpirtit Shenjt, atë që Ai do ta japë me bollëk në Misterin pashkor dhe që ngjall në ne shpresën që nuk zhgënjën. Në momentin kur kumton mundimet dhe vdekjen e Tij Jezusi kumton shpresën kur thotë: «të tretën ditë do të ngjallet» (Mt 20,19). Jezusi na flet për të ardhmen e hapur prej mëshirës së Atit. Të shpresosh me Të dhe falë Tij do të thotë të besosh se historia nuk mbyllet me gabimet tona, me dhunën dhe padrejtësinë tonë dhe me mëkatën që kryqëzon

Dashurinë. Do të thotë të marrësh prej Zembrës së tij të hapur faljen e Atit.

Në kontekstin aktual të shqetësimeve në të cilin jetojmë dhe ku gjithçka duket e brishtë dhe e paqartë, të flasësh për shpresë mund të duket si një provokim. Koha e Kreshmës është bërë për të shpresuar, për të rikthyer edhe një herë shikimin nga durimi i Hyjit, që vazhdon të kujdeset për Krijimin e Tij, të cilin ne shpesh e kemi keqtrajtuar (krh. Enc. *Laudato si'* [Ti qofsh lëvduar], 32-33.43-44). Do të thotë të shpresosh në pajtim, për të cilin na fton me pasion Shën Pali: «Pajtohuni me Hyjin!» (2Kor 5,20). Duke marrë faljen, në Sakramentin që është në zemër të procesit tonë të kthimit, bëhemi edhe ne përhapës të faljes: meqë ne vetë e kemi marrë, atëherë mund ta japim atë nëpërmjet aftësisë për të jetuar një dialog dashamirës dhe duke bërë një sjellje që e ngushëllon atë që është plagosur. Falja e Hyjit, edhe nëpërmjet fjalëve dhe gjesteve tona, na mundëson që të jetojmë një Pashkë vëllazërie.

Gjatë Kohës së Kreshmës, të jemi të kujdesshëm për të thënë «fjalë nxitjeje, që ngushëllojnë, japin forcë dhe shtytje, në vend të fjalëve që poshtërojnë, trishtojnë, acarojnë dhe përbuzin» (FT, 223). Nganjëherë, për të dhënë shpresë, mjafton të jemi një person i mirë «i cili lë mënjanë shqetësimet dhe urgjencat e veta për të kushtuar vëmendje, për të dhënë një buzëqeshje, për të thënë një fjalë nxitëse, për të krijuar një hapësirë dëgjimi në mes të kaq shumë shpërfilljeje» (FT, 224).

Në përqendrimin dhe në lutjen e heshtur, shpresa na dhurohet si frymëzim dhe dritë e brendshme, që ndriçon sfidat dhe zgjedhjet e misionit tonë: ja pse është themelore të përqendrohemi për t'u lutur (krh. Mt 6,6) dhe të takojmë, në fshehtësi, Atin e butësisë.

Të jetosh një Kohë Kreshmeje me shpresë do të thotë të jemi, në Jezu Krishtin, dëshmitarë të kohëve të reja, në të cilat Hyji i bën “të reja të gjitha gjërat!” (krh. Zb 21,5). Do të thotë ta marrim shpresën e Krishtit që jep jetën e vet në kryq dhe që Hyji ngjall të tretën ditë, të gatshëm për t'i dhënë përgjigje gjithsecilit që prej nesh kërkon arsyen e shpresës që është në ne (krh. 1Pjt 3,15).

3. Dashuria e jetuar në gjurmët e Krishtit, në vëmendjen dhe në dhembshurinë ndaj secilit, është shprehja më e lartë e fesë dhe e shpresës sonë

Dashuria gëzohet kur sheh që tjetri është duke u rritur. Ja pse ajo vuan kur tjetri jeton në angështi: i vetëm, i sëmurë, pa çati, i dëshpëruar, në nevojë... Dashuria është zelli i zembrës që na bën të dalim nga vetja jonë dhe që krijojnë lidhjen e bashkëndarjes dhe të bashkësisë.

«Duke u nisur nga “dashuria shoqërore” është e mundur që të shkohet drejt një qytetërimi të dashurisë, për të cilin të gjithë mund të ndihemi të thirrur. Dashuria-bamirësi, me dinamizmin e saj universal, mund të ndërtojë një botë të re, sepse nuk është një ndjenjë sterile, por mënyra më e mirë për të arritur rrugë të efektshme zhvillimi për të gjithë» (FT, 183).

Dashuria është dhuratë që i jep kuptim jetës sonë dhe falë të cilës ne i konsiderojmë ata që vuajnë prej privimit si anëtarë të vetë familjes sonë, si miq, si vëllezër. Edhe e pakta, nëse ndahet me dashuri, nuk mbaron kurrë, por shndërrohet në rezervë jete dhe lumturie. Kështu ndodhi edhe për miellin dhe vajin e vejushës së Sareptës, e cila i dha kulaçin e vet Elisë profet (krh. 1Mbr 17,7-16); dhe për bukët që Jezusi bekoi, ndau dhe ua dha nxënësve të vet për t'ia shpërndarë turmës (krh. Mk 6,30-44). Kështu ndodh edhe për lëmoshën tonë, e vogël apo e madhe qoftë, dhënë me gëzim e thjeshtësi.

Të jetosh një Kohë Kreshmeje dashurie do të thotë të kujdesesh për atë që jeton në vuajtje, i braktisur apo në angështi për shkak të pandemisë Covid-19. Në kontekstin e një pasigurie të madhe për të nesërmen, duke sjellë ndër mend fjalën që Hyji i thotë Shërbëtorit të vet: «Mos u tremb, se unë të shpërbleva» (Is 43,1), të dhurojmë me dashurinë tonë një fjalë besimi dhe të bëjmë që tjetri të ndiejë se Hyji e do si një bir.

«Vetëm me një vështrim horizonti i të cilës të shndërrohet nga dashuria-bamirësi, që e shtyn atë të dallojë dinjitetin e tjetrit, të varfrit njihen dhe vlerësohen në dinjitetin e tyre të pamasë, respektohen në stilin dhe kulturën e tyre, dhe për këtë arsye integrohen me të vërtetë në shoqëri» (FT, 187).

Të dashur vëllezër e motra, çdo etapë e jetës është një kohë për të besuar, për të shpresuar dhe për të dashur. Kjo thirrje për ta jetuar Kohën e Kreshmës si rrugëtim kthimi, lutjeje dhe bashkëndarjeje të të mirave tona, na ndihmon që ta rivizitojmë, me kujtesën tonë bashkësiore dhe personale, fenë që vjen prej Krishtit të gjallë, shpresën e gjallëruar prej frymës së Shpirtit Shenjt dhe dashurinë burimi i pashtershëm i të cilës është zemra e mëshirshme e Atit.

Maria, Nëna e Shpëtimtarit, besnike te këmbët e kryqit dhe në zembrën e Kishës, na mbështet me praninë e saj të kujdesshme, dhe bekimi i të Ngjallurit na shoqëroftë në ecjen tonë drejt dritës pashkore.

Romë, Shën Gjoni në Lateran, 11 nëntor 2020, përkujtimi i Shën Martinut të Turit (Francë)

MARRËDHËNIA E BESIMIT SI BAZË E KUJDESIT NDAJ TË SËMURËVE

*Mesazhi i Atit të Shenjtë Françeskut për ditën botërore të XXIX të të sëmurëve
Romë 11 shkurt 2021*

Vetëm njëri është Mësuesi juaj, kurse ju të gjithë jeni vëllezër (Mt 23,8)

Të dashur vëllezër e motra!

Kremtimi i Ditës Botërore të XXIX të të Sëmurëve, që bie me 11 shkurt 2021, në përkujtimin e së Lumes Virgjërës Mari të Lurdit, është moment i përshtatshëm që t'i kushtojmë një kujdes të veçantë personave të sëmurë dhe atyre që u shërbejnë qoftë në vende të caktuara për kujdesin e tyre qoftë në gjirin e familjeve dhe të bashkësive. Mendoj më së pari për ata që po vuajnë pasojat e pandemisë së koronavirusit në të gjithë botën. U shpreh afërsinë time të gjithëve, veçanërisht të varfërve dhe të mënjanuarve, duke ju siguruar përkujdesjen dhe dashurinë e Kishës.

1. Tema e kësaj Dite frymëzohet nga pjesa ungjillore ku Jezusi kritikon hipokrizinë e atyre që flasin por nuk veprojnë (krh Mt 23,1-12). Kur feja tkurret në veprimtari të shterpëta fjalësh, pa u përfshirë në histori dhe në nevojat e tjetrit, atëherë zvogëlohet koherenca mes besimit të shprehur dhe përjetimit real të saj. Rreziku është i rëndë; për këtë Jezusi përdor shprehje të forta, që të na ruajë nga rreziku i rënies në idhujtarinë e vetvetes, dhe shprehet: «*Vetëm njëri është Mësuesi juaj, kurse ju të gjithë jeni vëllezër*» (rr.8).

Kritika që Jezusi u drejton atyre që «thonë por nuk veprojnë» (rr. 3) është e shëndetshme gjithmonë dhe për të gjithë, sepse shpëton nga e keqja e hipokrizisë, një e keqe shumë e rëndë, që prodhon pasojën e pengesës së lulëzimit si bij të të njëjtit Atë, të thirrur për të jetuar një vëllazëri universale.

Përballë nevojës së vëllait apo motrës, Jezusi ofron një model sjelljeje krejtësisht të ndryshme nga hipokrizia. Propozon që të ndalemi, të dëgjojmë, të ndërtojmë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe personale me tjetrin, të kemi empati dhe dhembshuri për të, të lejojmë veten që të përfshihemi nga vuajtja e tyre deri sa ta marrim nën kujdes përmes shërbimit (krh Lk 10,30-35).

2. Përvoja e sëmundjes na bën të ndjejmë brishtësinë tonë dhe njëkohësisht nevojën e padiskutueshme të tjetrit. Gjendja e të qenit të krijuar bëhet akoma më e mprehtë dhe përjetojmë në mënyrë të qartë se i përkasim Hyjit. Në të vërtetë kur jemi të sëmurë paqartësia, frika dhe shpesh tronditja mbizotërojnë mendjen dhe zemrën; gjendemi në një



situatë paaftësie, sepse shëndeti ynë nuk varet nga aftësitë tona ose nga 'përpjekjet' tona (krh Mt 6,27).

Sëmundja shtron një pyetje mbi kuptimin e ngjarjeve, që me fe i drejtohet Hyjit: një pyetje që kërkon një domethënie të re dhe një drejtim të ri në ekzistencë, dhe që ndonjëherë nuk e gjen menjëherë përgjigjen. Edhe vetë miqtë dhe të afërmit nuk janë gjithmonë në gjendje të na ndihmojnë në këtë kërkim të vështirë.

Figura biblike e Jobit është figura simbolike e kësaj situatë. Gruaja dhe miqtë nuk arrijnë ta shoqërojnë në fatkeqësinë e tij, përkundrazi e akuzojnë duke ia shtuar më shumë vetminë dhe përumbjen. Jobi bie në një gjendje braktisjeje dhe moskuptimi. Por pikërisht përmes kësaj brishtësie të thellë, duke shmangur çdo lloj hipokrizie dhe duke zgjedhur rrugën e sinqeritetit drejt Hyjit dhe drejt tjerëve, ai bën që britma e tij këmbëngulëse të arrijë te Hyji, i cili në fund përgjigjet, duke i hapur një horizont të ri. I pohon që vuajtja e tij nuk është një dënim ose një ndëshkim, nuk është as një shenjë e largësisë nga Hyji ose shenjë e mospërfilljes së tij. Kështu nga zemra e plagosur dhe e shëruar e Jobit rrjedh ajo deklaratë e gjallë dhe mallëngjyese drejt Zotit: «Të njihja veç me të dëgjuar, e tani me sy të mi të pashë!» (Jb 42,5).

3. Sëmundja ka gjithmonë fytyrë, dhe jo vetëm një: ka fytyrën e një të sëmuri dhe të sëmure, edhe të atyre që ndihen të shpërfillur, të përjashtuar, viktimat të padrejtësive shoqërore që u mohojnë të drejtat themelore (krh. Enc. *Vëllezër të gjithë*, 22). Pandemia aktuale ka bërë që të dalin shumë pamjaftueshmëri të sistemeve shëndetësore dhe mangësi në asistimin e personave të sëmurë. Të

sëmureve, më të dobtëve dhe më të brishtëve jo gjithmonë u është ofruar qasje në përkujdesje dhe jo gjithmonë u është ofruar në mënyrë të drejtë. Kjo varet nga zgjedhjet politike, nga mënyra e administrimit të burimeve dhe të angazhimit të atyre që mbështjellen me rolin e përgjegjësive. Të investosh burimet në përkujdesjen dhe në ndihmën e personave të sëmurë është një përparësi ligjore sipas principit që shëndeti është një e mirë e përbashkët parësore.

Në të njëjtën kohë pandemia ka vendosur në pah edhe përkushtimin dhe bujarinë e operatorëve shëndetësorë, të vullnetarëve, të punëtorëve dhe punëtorëve, të meshtarëve, të rregulltarëve e rregulltarëve, që me profesionalizëm, me vetmohim, me ndjenjë përgjegjësie dhe dashurie për të afërmin kanë ndihmuar, janë përkujdesur, i kanë ngushëlluar dhe shërbyer shumë të sëmurë dhe familjarë të tyre. Një sërë burrash dhe grash në mënyrë të heshtur kanë vendosur të shohin ato fytyra, duke marrë përsipër plagët e pacientëve që i konsideronin të afërm në virtut të përkatësisë në të njëjtën familje njerëzore.

Afërsia, në fakt, është një balsam i çmuar, që mbështet dhe ngushëllon atë që vuan në sëmundje. Si të krishterë, jetojmë afërsinë si shprehje e dashurisë së Jezui Krishtit, *Samaritanit të mirë*, që me dhembshuri është bërë i afërm i çdo qenie njerëzore, të plagosur nga mëkati. Të bashkuar me Të, falë veprimit të Shpirtit Shenjt, jemi të thirrur të jemi të mëshirshëm sikur Ati dhe të duam veçanërisht vëllezërit e sëmurë, të dobët dhe ata që vuajnë (krh *Gjn* 13,34-35). Dhe e jetojmë këtë afërsi, përveçse në mënyrë personale, edhe në formë bashkësiore: në fakt dashuria vëllazërore në Krishtin lind një bashkësi të aftë për shërim, që nuk braktis askënd, që përfshin dhe mirëpret mbi të gjitha më të dobët.

Prandaj dëshiroj të kujtoj rëndësinë e solidaritetit vëllazëror, që shprehet konkretisht në shërbim dhe mund të marrë forma shumë të ndryshme, të gjitha të drejtuara kah mbështetja e të afërmit. «Të shërbesh d.m.th të kesh kujdes për ata që janë të dobët në familjet tona, në shoqërinë tonë, në popullin tonë» (*Homelia në La Habana*, 20 shtator 2015). Në këtë angazhim secili është i aftë të «vendos mënjanë nevojat dhe pritshmëritë vetjake, dëshirat e tij të gjithëpushtetshmërisë përballë shikimit konkret të më të dobëtëve. [...] Shërbimi shikon gjithmonë fytyrën e vëllait, prek mishin e tij, ndjen afërsinë e tij deri sa në disa raste ta 'vuajë', dhe kërkon përparimin e vëllait. Për këtë arsye shërbimi nuk është asnjëherë ideologjik, duke qenë se nuk u shërben ideve, por personave» (*Homelia në La Habana*).

4. Që të jetë një terapi e mirë, është vendimtare aspekti relacional, përmes së cilës mund të bëhet një sjellje e gjithanshme ndaj personit të sëmurë. Të vlerësosh këtë aspekt ndihmon edhe mjekët, infermierët, profesionistët dhe vullnetarët që të mbartin ata që vuajnë për ti shoqëruar drejt një procesi shërimi, falë një marrëdhënieje ndërpersonale dhe besimi (krh *Karta e re e Operatorëve Shëndetësorë* [2016], 4). Pra bëhet fjalë që të vendoset një pakt mes nevojtarëve për kujdes dhe atyre që kujdesen; një pakt i themeluar mbi besimin dhe respektin reciprok, mbi sinqeritetin, mbi gatishmërinë, kështu mund të tejkalohet çdo lloj barriere mbrojtëse, të vendoset në qendër dinjiteti i të sëmurit, të kujdeset profesionaliteti i operatorëve shëndetësor dhe të mbahet një raport i mirë me familjet e pacientëve.

Pikërisht kjo marrëdhënie me personin e sëmurë gjen një burim të pashtershëm motivimi dhe force në *dashurinë e Krishtit*, siç tregon dëshmia mijëvjeçare e burrave dhe grave që janë shenjtëruar duke u shërbyer të sëmurëve. Në fakt nga misteri i vdekjes dhe i ngjalljes së Krishtit rrjedh ajo dashuri që është e aftë t'i japë kuptim të plotë qoftë gjendjes së pacientit qoftë të atij që përkujdeset. Këtë e dëshmon shumë herë Ungjilli, duke treguar se shërimet e bëra nga Jezusi nuk janë asnjëherë gjeste magjike, por gjithmonë si fryt i një *takimi*, i një *marrëdhënieje ndërpersonale*, në të cilin dhurata e Hyjit, e ofruar nga Jezusi, përkon me fenë e atij që e pranon, siç e përmbledh fjala që Jezusi shpesh përsërit: 'Feja jote të shpëtoi'.

5. Të dashur vëllezër e motra, urdhri i dashurisë, që Jezusi u ka lënë nxënësve të vet, gjen një marrëdhënie konkrete edhe në raport me të sëmurët. Një shoqëri është më njerëzore sa më shumë që të kujdeset për anëtarët e dobët dhe të vuajtur dhe di ta bëjë me efikasitet të frymëzuar nga dashuria vëllazërore. Të drejtohem i kah ky qëllim dhe të bëjmë të mundur që askush të mos qëndrojë vetëm, që askush të mos ndihet i përjashtuar dhe i braktisur.

Ia besoj Marisë, Nënës së Mëshirës dhe Shëndetit të sëmurëve, të gjithë të sëmurët, operatorë shëndetësor dhe ata që qëndrojnë afër të vuajturve. Nga shpella e Lurdit dhe nga shumë shenjtëroret e saj të shpërndara nëpër botë, Ajo e mbajttë fenë dhe shpresën tonë, dha na ndihmoftë që të kujdesimi për njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore. Mbi të gjithë dhe mbi secilin prej jush jap nga zemra bekimin tim.

**Romë, Shën Gjoni në Lateran,
20 dhjetor 2020,
e Diela e IV e Ardhjes.**

“KULTURA E PËRKUJDESJES SI RRUGËTIM PAQEJE”

Paraqitja e mesazhit për Ditën Botërore të Paqes

Shkodër, 8 janar 2021

Në Mesazhin e Ditës Botërore të Paqes 2021 Papa na kujton atë që ka shkruar në enciklikën e tij të fundit “Vëllazëri të gjithë”: “Në shumë vende të botës ka nevojë për rrugëtime paqeje, që çojnë në shërimin e plagëve, ka nevojë për artizanë të paqes të gatshëm për të nisur procese shërimi dhe takimi të ripërtërirë me zgjuarsin dhe guxim”. I inkurajon të gjithë që të bëhen “profetë dhe dëshmitarë të kulturës së përkujdesjes, për të zhdukur pabarazitë e shumta shoqërore”.

Françesku i shikon ngjarjet e vitit 2020, shënuar “prej krizës së madhe shëndetësore të Covid-19” e cila ka rënduar kriza mes tyre fortësisht të ndërlydhura, “si ajo klimatike, ushqimore, ekonomike dhe migruese”. Papa mendon para së gjithash “për ata që kanë humbur një familjar apo një person të dashur, por edhe për ata që kanë mbetur pa punë”. E në mënyrë të veçantë kujton mjekët, infermierët, farmacistët, kërkuesit, vullnetarët, kapelanët dhe personelin e spitaleve dhe të qendrave shëndetësore.

Po ashtu, Papa ripërtërin apelin drejtuar politikëbërësve dhe sektorit privat, “me qëllim që të marrin masat e duhura për të garantuar mundësinë e bërjes së vaksinës kundër Covid-19 dhe të pasjes së teknologjive thelbësore për t'i mjekuar të sëmurët dhe të gjithë atë që janë më të varfër dhe më të brishtë”.

Pandemia dhe ngjarje të tjera që kanë shënuar ecjen e njerëzimit gjatë vitit 2020, thekson Papa... «na mësojnë rëndësinë që të kujdesemi për njëritjetrin dhe për krijimin, me qëllim që të ndërtojmë një shoqëri të bazuar në marrëdhënie vëllazërie”.

Papa i vë bazat e “kulturës së përkujdesjes” në Hyjin Krijues, model i përkujdesjes, i cili “përkujdeset për krijesat e veta, në veçanti për Adamin, Evën dhe fëmijët e tyre”.

“Nxitja e dinjitetit të çdo personi njerëzor, solidariteti me të varfrit dhe të pambrojturit, zelli për të mirën e përbashkët, mbrojtja e krijimit”: katër parime bazë që Françesku i analizon një për një, duke nisur nga mbrojtja e dinjitetit të personit “krijuar për të jetuar së bashku në familje”, në një shoqëri, “ku të gjithë anëtarët janë të barabartë në dinjitet”. Një dinjitet prej nga ku rrjedhin të drejtat dhe detyrat, si p.sh. përgjegjësia “për t'i mirëpritur dhe për t'i ndihmuar të varfrit, të sëmurët, të mënjanuarit, çdo të afërm”.

Gjatë pandemisë Covid-19 “kemi kuptuar se gjendemi në të njëjtën barkë, të gjithë të brishtë dhe të çorientuar, por në të njëjtën kohë të rëndësishëm dhe të nevojshëm, të gjithë të thirrur për të vozitur së



bashku”. Pra, të tregosh solidaritet, përsërit Papa, do të thotë të angazhohesh për të mirën e të gjithëve dhe të secilit. Prej dëgjimit të vëmendshëm të britmës së nevojtarëve dhe asaj të krijimit “mund të lindë një përkujdesje e efektshme ndaj tokës”, shtëpisë sonë të përbashkët, “dhe ndaj të varfërve”, duke pasur parasysh se “një ndjenjë e ngushtë bashkimi me qeniet e tjera të natyrës” nuk mund të jetë e njëmendtë nëse në të njëjtën kohë nuk shoqërohet nga dhembshuri “për qeniet njerëzore”.

Françesku i fton përgjegjësit e Organizatave ndërkombëtare dhe të Qeverive, që ta marrin në dorë këtë “busullë” të parimeve të Doktrikës Shoqërore të Kishës, për t'i dhënë një drejtim të përbashkët procesit të globalizimit, “një drejtim vërtet njerëzor”. Rikujton edhe propozimin e bërë Ditën Botërore të Ushqimit: “Me paratë që investohen në armë dhe ndërmarrje të tjera ushtarake të krijohet një 'Fond botëror' për ta çrrënjësuar përfundimisht urinë dhe për të kontribuar në zhvillimin e Vendeve më të varfra”.

Bëhet themelor “një proces edukativ” për kulturën e përkujdesjes, që lind në familje dhe që zhvillohet në shkollë e universitet, dhe nëpërmjet mediave. Udhëheqësit e besimeve fetare në veçanti, shpjegojnë sërisht Françesku, “mund të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në përcimin e vlerave të solidaritetit, të respektimit të ndryshimeve, të mirëpritjes dhe të përkujdesjes ndaj vëllazërve më të brishtë”.

Papa e përfundon mesazhin e tij duke theksuar se nuk mund të ketë paqe “pa një kulturë të përkujdesjes”, pa një angazhim të përbashkët “për të mbrojtur dhe për të nxitur dinjitetin dhe të mirën e të gjithëve” për t'u interesuar, për të provuar dhembshuri, për t'u pajtuar dhe për t'u shëruar, për t'u respektuar në mënyrë të dyanshme dhe për t'u mirëpritur në mënyrë të ndërsjellë.

Imzot Angelo MASSAFRA O.F.M.

Dom Artur Jaku

“NATYRA KA KRIJUAR NJË TË DREJTË PËR TË GJITHË”

*Mesazhi i Ditës Botërore të Paqes 2021
Shkodër, 8 janar 2021*

Është kthyer në një traditë që në çdo fillim viti, Papa tu drejtohet të gjithë besimtarëve, njerëzve vullnet mire, drejtuesve të shteteve, me një mesazh, sa atërore aq edhe ndriçues për mendjet dhe zemrat, në detyrën dhe përgjegjësinë që secili prej nesh kemi, në ndërtimin e drejtësisë, së mirë dhe paqes së gjithmbarshme.

“Kultura e Përkujdesjes si Rugëtim Paqeje” të sjell menjëherë ndërmend filozofinë e njohur të Papa Gjon Palit II, i cili edhe në takimet mjaft të njohura të “Ditëve Botërore të Rinisë”, i adresonte fuqishëm të rinjve, thirrjen për krijimin e “Civilizimit të Dashurisë” duke e cilësuar ndërkohë aktualitetin e epokës së tij me emërtimin: “Civilizimi i Vdekjes”.

Krahasuar me diskursin e Papa Françeskut për “Kulturën e Përkujdesjes” që ndërkohë e gjen botën tashmë kryekëput të globalizuar dhe në një krizë të thellë humanitare e shëndetësore deri në zgrip të kolapsit, diskursi i Papa Gjon Palit II adresuar të rinjve të mbledhur nga të gjitha shtetet e te gjitha kombeve, gjatë Ditëve Botërore të Rinisë, duket se shpërfaq ndërkohë një paradigmë të vetë globalizmit. Por ajo që të bie në sy nga ky krahasim analogjik, është në fakt se edhe pse shprehur nga dy Papë të ndryshëm në bashkoheshit e tyre të ndryshme, diskursi i Kishës në thelb mbetet i pandryshuar dhe për këtë arsye edhe profetik.

Shembuj të tjerë analogë në këtë drejtim, mund të ishin ndoshta të panumërt, por çka do të vlente të theksohej është se ky diskurs profetik i Kishës është pikërisht i tillë pasi frymëzohet dhe mbështetet në Shkrimin e Shenjtë. Jo më kot, në hyrje të mesazhit të tij Ati i Shenjtë na sjell në kujtesë Librin e Zanafillës i cili: zbulon, që në fillim, rëndësinë e përkujdesjes dhe të ruajtjes në projektin e Hyjit për njerëzimin, duke vënë në dukje marrëdhënien mes njeriut ('adam) dhe tokës ('adamah) dhe mes vëllezërve. Në tregimin biblik të krijimit, Hyji e lë kopshtin “e mbjellë në Eden në duart e Adamit me detyrën që “ta punojë dhe ta ruajë”.

Në këtë kontekst, është me po aq interes të theksohet se edhe sipas filozofisë moderne, “Njeri” (Adam) etimologjikisht do të thotë “Sens i masës” ose thënë ndryshe “Njësia matëse e vlerësimit të gjërave”. Është padyshim humbja e “Sensit të Masës” tek Njeriu apo vetë humbja e Njeriut si “Njësia matëse e vlerësimit të gjërave” që e ka bërë



edhe vetë njerëzimin jo vetëm skllav të mëkatit fillestar por edhe viktimë të ndërhyrjes së Tragjedisë në Histori nëpërmjet vëllavrasjes së Kainit ndaj Abelit. Papa na e risjell ndërmend aktin fatal të përshkruar në Bibël në Librin e Zanafillës pasi vrau vëllanë e vet Abelin, Kaini i përgjigjet kështu pyetjes së Hyjit: «Pse a mos jam unë rojtari i tim vëllai?» - duke komentuar në vijim Ati Shenjtë vren: “Po, sigurisht! Kaini është “rojtari” i vëllait të vet.” Shenjtëria e Tij i referohet gjithashtu edhe pohimit të Shën Ambrozit se: «Natyra i ka ruajtur të gjitha gjërat për njerëzit me qëllim përdorimin e përbashkët të tyre. [...] Për këtë arsye, natyra ka krijuar një të drejtë për të gjithë, por lakmia e ka bërë atë një të drejtë për pak vetë». Lakmia që errëson sytë e nxin zemrat sikurse Kainit, a nuk është vallë shkaku i sa e sa padrejtësive dhe vuajtjeve socio-ekonomike sidomos në shoqëritë moderne e bashkëkohore. A nuk ngjajnë sistemet ekonomike të këtyre të fundit gjithmonë e më shumë si djepet e “Kulturës së Skartimit” apo thënë ndryshe të “Kulturës së Flakjes”? A nuk ngjan kaq dramatikisht i prekshëm dhe aktual thirrja e Profetëve si Amosi, Isaia “që ngrënin vazhdimisht zërin e tyre në favor të drejtësisë ndaj të varfërve, të cilët, për shkak të cenueshmërisë së tyre dhe të mungesës së fuqisë, dëgjohen vetëm prej Hyjit, që përkujdeset për ta? Nisur nga kjo, do të ishte vetvetishëm e kuptueshme dhe e vlefshme për shoqëritë e çdo epoke referimi që Papa Françesku bën ndaj dokumentit “Gaudium et Spes” nga ku parashtrahet se: “Çdo aspekt i jetës shoqërore, politike dhe ekonomike gjen plotësinë e vet kur vihet në shërbim të së mirë së përbashkët, «domethënë të tërësisë së atyre kushteve të jetës shoqërore që u lejojnë si grupeve ashtu edhe

individëve ta arrijnë përsosmërinë e tyre më plotësisht dhe më shpejt». “Solidariteti – shkruan ai në vijim - na ndihmon ta shohim tjetrin - si person dhe, në kuptimin e gjerë, si popull apo komb - jo si një të dhënë statistikore apo si një mjet për t'u shfrytëzuar dhe pastaj për ta shkartuar kur nuk është më e dobishme, por si të afërmin tonë, shok udhëtimi, i thirrur për të marrë pjesë, njëlloj si ne, në banketin e plotnisë së jetës ku të gjithë jemi njëlloj të thirrur prej Hyjit.” Dhe kjo nuk ngjan të jetë aspak një përqasje utopike.

Shembulli pothuajse i harruar që Papa Françesku na risjell në vëmendje, është sa origjinal e i vërtetë, po aq edhe befasues: “Kremtimi i Jubileut, në përkujtim të vitit të shtatë sabbatit, bënte që për një vit toka, skllëvërit dhe borxhlinjtë të pushonin. Në këtë vit hiri, u kushtohej përkujdesje më të brishtëve, duke u ofruar atyre një perspektivë të re jete, me qëllim që të mos kishte asnjë nevojtar në popull”. Në vijim, Papa Françesku thekson se pikërisht: “Këto veprime mesianike, tipike të judënvë, përbëjnë dëshminë më shprehëse të misionit besuar prej Atit. Në dhembshurinë e tij, Krishti u afrohet të sëmurëve në trup e shpirt dhe i shëron ata; i fal mëkatarët dhe u jep atyre një jetë të re.

Jezusi është Bariu i Mirë që kujdeset për grigjën; është Samaritani i Mirë që përkulet mbi njeriun e plagosur, që mjekon plagët e tij dhe që kujdeset për të”. E gjithashtu nga ana tjetër, me shumë të drejtë duke iu referuar mesazhit të tij në enciklikën “Laudato Si”, Papa shton se: «Nuk mund të jetë e njëmendtë një ndjenjë e ngushtë bashkimi me qeniet e tjera të natyrës, nëse në të njëjtën kohë në zemër nuk ka ëmbëlsi, dhembshuri dhe shqetësim për qeniet njerëzore». Nga gjithçka mund të kuptojmë se të Vërtetën e Shpallur, pra zbulimi që na vjen nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta, që nga fillimi i kohërave dhe që do t'na shoqërojë deri në fundin e tyre, ne nuk mundet ta ndryshojmë e as ta tjetërsojmë duke e zëvendësuar me idhuj të rrejshëm, qofshin ato ideologji të përgjakshme totalitare apo të tjera më joshëse me trajta hedonizmi, liberalizmi e konsumerizmi, e aq më pak akoma ta “shartojmë”, pra ta përdorim me oportunitizëm si një njësi apo entitet konsumi sipas “kostumit” që do t'na rrinte më mirë për shtat, apo sipas interesave të çastit. Jo! Në fakt ajo çka do të mund të ishim ne në gjendje të ndryshonim përballë këtij konteksti, do të ishte vetëm Zemra jonë.

Ungjilli dhe e gjithë doktrina dhe

mësimet e Kishës, sikurse edhe tradita e pasur liturgjike e artistike në funksion të tyre, i drejtohen pikërisht Zemrës njerëzore në të gjithë individualitetin dhe veçantitë e saj, e në të njëjtën kohë ato i drejtohen gjithashtu edhe gjithë njerëzimit mbarë. Shpëtimi gjendet në pendesën autentike, në konvertimin e plotë të Zemrës pra, në kontaktin vetjak e ngadhënjyes të personit me Hyjin. Atëherë dhe vetëm atëherë, kur ky konvertim i individit është autentik, mund të flitet për komunitet, për bashkësi apo për vëllazëri, për “Kulturë të Përkujdesjes” apo “Civilizim të Dashurisë”. Çka do të thotë me fjalë të tjera se, çdo përgjegjësie kolektive në radhë të parë e mbi të gjitha, i paraprin përgjegjësia vetjake dhe se e mira e përbashkët gjithashtu, nuk mundet të arrihet autentikisht në mungesë të përgjegjshmërisë individuale.

Në bashkëkohësinë tonë Postmoderne, apo të ashtuquajtur “Post Humane” sikurse disa të tjerë do të preferonin ta cilësonin, nuk do të ishte kurrë vonë e aq më pak anakronizëm për t'u kthyer tek “Njeriu - Sens i Masës” madje, edhe më mirë në fakt, nëse do të kërkonim sakaq hiri e nevojshëm për të kuptuar drejtë binomin Adam – Adamah, për të cilin flet Libri i Zanafilles në Bibël. Mbi të gjitha, një kthesë e tillë shpirtërore për cilindo të krishterë në rradhë të parë, do të ishte edhe një shans kuriozues, një mundësi e artë që do t'i përngjante një “pasqyre të papërthyeshme” ku secili do të mund të kundronte refleksin e ndërgjegjes vetjake përballë “Kulturës së Flakjes”, apo thënë ndryshe “Kulturës së Skartimit”. E që të njohim më mirë vetveten e gjithashtu edhe sivëllezërit tanë në përpjekjen drejt paqes autentike, le të jetë pra “Civilizimi i Dashurisë” apo “Kultura e Përkujdesjes” për ne, forma *mentis* apo busulla jonë e orientimit, sikurse e uron edhe Papa Françesku.



KEMI SHUMË PËR TË REFLEKTUAR DHE PËR TË VËNË NË JETË!

*Homeli me rastin e 24-vjetorit të shugurimit Ipeshkëv
të Imzot Angelo Massafra-s O.F.M.
6 janar 2021*



“Mendoj se patjetër do të keni marrë vesh për hirin që Hyji, për ta çuar në vend synimin e vet, ma ka dhënë për të mirën tuaj” (Ef3,2).

Fjalët e Shën Palit, dëgjuar në leximin e dytë, shoqërojnë çdo vit përvjetorin e shugurimit tim ipeshkëvnor në të njëjtën ditë me solemnitetin e Dëftimit të Zotit.

Me këto fjalë Apostulli u paraqet besimtarëve të Efesit zanafillën e thirrjes së tij dhe qëllimin e misionit të tij: “(...) se paganët - në Jezu Krishtin - janë bashkëpjesëtarë të të njëjtit trashëgim, bashkëgjymtyrë të të njëjtit trup, dhe bashkëanëtarë të të njëjtit premtim në saje të Ungjillit” (Ef 3,6). Me fjalë të tjera, për të realizuar ëndrrën e Zotit, atë të një njerëzimi të mbledhur rreth Krishtit në një familje të madhe.

Shën Pali na tregon se cili është mjeti i nevojshëm për ta arritur këtë qëllim: domethënë Ungjilli, lajmi i mirë që na largon idenë e vjetër të një Zoti të lig, i cili i nënshtron njerëzit duke i mbajtur skllëvër përmes injorancës. Në vend të kësaj, Jezusi paraqitet si Fjala e Atit që kemi soditur në misterin e Krishtlindjes, koha liturgjike që kjo festë mbyll.

Duke përdorur të njëjtën terminologji të Shën

Palit mund të them se, me ardhjen e Jezusit, velloja e vendosur në fytyrën e Moisiut, me qëllim që lavdia e Hyjit që shkëlqente në fytyrën e tij pasi na kishte folur ballë për ballë me Të të mos i verbonte Izraelitët, tani është hequr në mënyrë që të gjithë ta sodisin fytyrën e vërtetë të Hyjit në fytyrën e Birit të tij Jezus, të parëlindurit, të dashurit, siç do ta dëgjojmë të Dielën e ardhshme në Ungjillin e Pagëzimit të Zotit. Një fytyrë, ajo e Jezusit në të cilën mund të sodisim edhe fytyrën tonë, atë të bijve të dashur. “Sepse tokën po e mbulon terri dhe një errësirë e madhe mbulon popujt, kurse mbi ty shkelqen drita e Zotit e Lavdia e tij mbi ty, do të shihet!” (Is 60,2). Kështu kemi dëgjuar në leximin e parë përshkrimin që Isaia profet jep për kohët tashmë të përmbushura të pranisë së Mesisë.

Pra, shkuarja te Krishti është mënyra që na çon në njohjen e Hyjit dhe të planit të tij të dashurisë për njerëzimin: ta njohim veten, domethënë bij në Birin, pjesëmarrës të një atësi të vetme, atë të Hyjit që na bën të gjithë vëllezër, me të gjitha pasojat që kjo sjell: paqe, harmoni, solidaritet, dashuri vëllazërore, kapërcim konfliktesh.

Por, realiteti në të cilin jetojmë, edhe pse kanë kaluar dy mijë vjet nga lindja e Krishtit, është krejt i ndryshëm. Me të drejtë, Ati i shenjtë Françesku në



Enciklikën “*Vëllezër të gjithë*”, të cilën së shpejti do ta kemi në duar edhe në shqip, përshkruan efektet katastrofike të këtij largimi nga Krishti dhe të faktit se nuk ndihemi më pjesë e atësisë së përbashkët të Hyjit. Kemi shumë për të reflektuar dhe për të vënë në jetë nëse nuk duam të rrezikojmë të jemi të krishterë vetëm me fjalë.

Edhe për këtë arsye, Papa Françesku ka shpallur vitin kushtuar Shën Jozefit, duke thënë se bota ka nevojë për atësinë: pa atësi nuk ka birësi dhe nëse nuk ndihemi bij nuk mund të ndihemi as vëllezër. Po me të njëjtën arsye justifikohet viti kushtuar familjes, pasi mund të ndihemi me të vërtetë pjesë e një familjeje të madhe vetëm aty ku dashuria është rregulli i vetëm që përcakton qenien tonë dhe të vepruarit tonë.

Sigurisht, festa e Dëftimit të Zotit na kujton nevojën që kjo dashuri të arrijë tek të gjithë njerëzit, të përfaqësuar nga dijetarët e Ungjillit të Mateut që kemi dëgjuar pak më parë; aq sa sot në mbarë Kishën kremtohet edhe Dita e Fëmijërisë Misionare përmes të cilës sensibilizohen më të vegjlit për t’ia kumtuar Ungjillin bashkë-moshatarëve të tyre të të gjitha kontinenteve. Por vendi për të filluar zbatimin e rregullit të dashurisë është bota jonë e vogël: shtëpia jonë, të afërmit tanë, miqësitë tona, marrëdhëniet e punës; për të arritur pastaj deri sferat më të larta të shoqërisë njerëzore.

Pothuajse të gjithë, tashmë, jemi njohur me mjetet e komunikimit shoqëror, sidomos me internetin, vendin që më shumë përfaqëson globalitetin dhe na afron të gjithëve më tepër, edhe pse virtualisht. Epo, pikërisht interneti, duke i dhënë hapësirë diçkaje negative që kemi brenda vetes, ka zhvilluar një kategori njerëzish të quajtur “*haters*”, fjalë për fjalë “*urrejtës*”. Potencialisht të

gjithë jemi të tillë: duke kritikuar dhe duke dënuar. Një modë që është duke u rritur gjithnjë e më shumë dhe në të cilën edhe ne të krishterët jemi duke rënë pa e kuptuar.

Vëllezër dhe motra, ka ardhur koha që të jemi më të vetëdijshëm se kush jemi dhe për misionin që Zoti na ka besuar: atë të dashurisë dhe jo urrejtjes. Pagëzimi ynë na e kërkon këtë gjë; dhe menjëherë pas këtyre fjalëve të mia, sipas traditës, në këtë ditë të Dëftimit të Zotit, do të ripërtërijmë premtimet tona të pagëzimit dhe do të stërpikemi me ujin e bekuar, të cilin më pas mund ta marrim në shtëpitë tona në kujtim të asaj ngjarjeje që na bërë të ngjashëm me Krishtin.

Po, sepse është Ai që duhet t’ia dëftojmë botës (ky është kuptimi i fjalës Epifani!), por për ta bërë këtë gjë duhet t’i bashkëngjitemi gjithnjë e më shumë Krishtit dhe Ungjillit të tij. Duhet të kemi më shumë familjaritet me Ungjillin: ta lexojmë, ta meditojmë dhe ta zbatojmë në jetën tonë të përditshme.

Le t’i kushtojmë disa minuta në ditë dëgjimit të disa pjesëve të Ungjillit që shpallet në Meshën e shenjtë së bashku me predikimin; sepse siç thoshte Shën Jakob della Marca: “*Ku na është dhënë vërtet për ta marrë Shpirtin Shenjt? Përmes predikimit. Ku qan për mëkatet e tua dhe ku i fal sharjet që të kanë bërë? Në predikim. Ku e vendos vullnetin tënd të keq dhe merr durim dhe gjen shpirtin e humbur? Përmes predikimit. Ku e ke njohur Hyjin dhe ku të paudhët bëhen të drejtë? Për shkak të predikimit. Ku falen shumë mëkate, vrasjet, paturpësitë, pabesitë, urrejtjet dhe gjërat e tjera të këtij lloji? Nëpërmjes predikimit. Çfarë i ka mbajtur njerëzit nëfe? Predikimi*”.

Falënderoj Zotin që më ka thirrur në këtë mbarështim apostolik për të mirën tuaj. Atij i kërkoj që krejt Kisha në Shkodër-Pult të përbëhet nga besimtarët që e duan Ungjillin, të aftë për ta pasur atë si rregull jete, në mënyrë që të gjitha veprimtaritë tona të drejtohen kah Hyji dhe ata që nuk besojnë të preken nga feja, shpresa dhe dashuria jonë.

Dhe ju lutuni për mua, në mënyrë që të vazhdoj të jem besnik ndaj këtij mbarështimi predikues dhe lutës, në mënyrë që së bashku t’ia arrijmë qëllimit për të cilin na thërret Zoti, atë të bashkimit të përsosur me Të në mbretërinë e Qiellit. Amen!

Dom Gjovalin Simoni

NATYRA MË E THELLË E KISHËS NË TË SHPALLURIT E FJALËS SË ZOTIT

(Tërheqje shpirtërore)
Shkodër, 12.11.2020

“Kush në jetën e tij, i ka ndezur edhe vetëm një qiri dikujt që ka pasur nevojë, jeta e tij nuk ka qenë e kotë”.
(Shën Tereza e Kalkutës)

“Me bamirësinë ndaj të afërmit, i varfëri është i pasur dhe pa bamirësinë ndaj të afërmit, i pasuri është i varfër”. (Shën Agustini)

Këtë vit baritor që kemi filluar, sipas nxitjes së Letrës Baritore të Arqipeshkvit tonë, “Gëzimi i Dëshmisë”, jemi të thirrur që të jetojmë “vitin e misionit”; “...dhe çdo gjuhë të dëshmojë: Jezu Krishti është Zot” (Fil 2,11). Gjatë këtij viti do të përpiqemi që të vendosim në qendër të baritores sonë angazhimin tonë konkret në vepra e bamirësisë dhe jo vetëm; për të jetuar jo vetëm me fjalë por edhe me vepra konkrete fenë tonë. Edhe vetë Shën Françesku ju thoshte vëllezërve të tij: “Dilni e predikoni Ungjillin, e nëse është nevoja edhe me fjalë”.

Natyra më e thellë e Kishës është shprehur në përgjegjësinë e saj të trefishtë: në të shpallurit e Fjalës së Zotit (*Kerygma-martyria*), në të kremtuarit e sakramenteve (*liturgia*), dhe në të ushtruarit e shërbimit të bamirësisë (*diakonia*). Këta detyra nënkuptojnë njëra-tjetrën dhe janë të pandashme. Për kishën bamirësia nuk është një lloj aktiviteti mbarëvajtjeje, i cili barazisht mund t'u lihet të tjerëve, por është pjesë e natyrës së saj, është shprehje e domosdoshme e ekzistencës së saj.

Kam menduar që të udhëhiqemi në këtë meditim nga kjo pjesë e Ungjillit të Lukës 10,25-37:

Kur qe, u ngrit një dijetar Ligi dhe, me qëllim që ta provojë, e pyeti Jezusin: “Mësues, çka duhet të bëj për të fituar jetën e pasosur?” Iu përgjigj Jezusi: “Çka shkruan në Ligi? Si lexon atje?” Dijetari iu përgjigj: “Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë fuqinë tënde dhe me gjithë mendjen tënde, dhe të afërmin tënd porsì vetveten.”²⁸ Jezusi i tha: “Mirë u përgjigje! Vepru kështu dhe do të jetosh!” Por ai, duke dëshiruar të përlligjej, e pyeti Jezusin: “Kush është i afërmi im?” Jezusi vazhdoi e tha: “Një njeri po zbriste prej Jerusalemit në Jerihon e ra ndër cuba. Këta e plaçkitën, e rrahën dhe ikën e lanë veç gjallë. Rastësisht po asaj rrugë po zbriste një prift. E pa, iu shmang e vazhdoi rrugën. Po ashtu edhe një levit, kur arriti aty, e pa, iu shmang dhe e vazhdoi udhën. Kurse një samaritanas, duke udhëtuar, kur erdhi tek ai dhe e pa, pati dhimbë për të, iu afrua, ia lidhi plagët duke ia pasë larë me verë e me vaj. Mandej e vuri mbi shtazën e vet, e çoi në bujtinë dhe

u kujdesua për të. Të nesërmen, nxorri dy denarë, ia dha bujtinarit dhe i tha: ‘M'u kujdes për të dhe, çka të shpenzosh më shumë, do t'i jap kur të kthehem.’ Cili prej këtyre të treve, të thotë mendja, u dëftua i afërmi i atij njeriu që ra ndër cuba?” Ai iu përgjigj: “Ai që pati mëshirë për të!” “Shko – i tha Jezusi – e bëj edhe ti ashtu!”

Dialogu mes Jezusit dhe dijetarit, hapet me pyetjen që ky i fundit i drejton Krishtit: *Mësues, çka duhet të bëj për të fituar jetën e pasosur?* Duket sikur, jeta e pasosur është vetëm sforco e veprave njerëzore, por pa dashur të hyjmë në këtë analizë, Jezu e dinte mirë që tradita hebreje, ishte rigoroze në mbajtjen e 613 rregullave Biblike. Duke parë këtë saktësi të ftohtë përgjigjejeje, që nuk kishte të bëjë aspak ndoshta me ndjenjat dhe qëllimet e thella fetare, Jezusi përpiket për t'i dhënë një fytyrë personale atij “të afërmit” për të cilin pyet dijetari. Pra, Jezusi e kalon argumentin nga aspekti objektiv: *kush është i afërmi?*; në aspektin subjektiv: *kush ka vepruar si i afërm?*. Në personin e gjakosur, të rrahur dhe të braktisur gjendet njerëzimi i grabitur e plaçkitur në dinjiteti i vet. Afër tij kalojnë një levit dhe një meshtarë, te dy që sipas traditës nuk mund të “ndotnin” duar me gjakun e të plagosurit, sepse kështu thoshte ligji, rregullorja e religjioni i tyre. Duhet të kalonte një “i huaj”, samaritanas, që t'ju jepte shembullin e shërbimit. Është pikërisht ky samaritanas në të cilin Jezusi e personifikon të afërmin. Ky është i afërmi, ai që e lejon veten të preket në zemër. I afërmi nuk është vetëm ai i mishit e i gjakut, i religjionit, i fisit, i klanit, i atij që mendon si ti. I afërmi në këtë rast bëhet “i huaj”. Ajo që e shtyu pikërisht këtë samaritanas, që të kujdesej për të, ishte mëshira. Ky samaritanas, nuk ka bërë diçka shumë të veçantë në fund të fundit, por mendoj se dy gjëra spikasin: a) *liria e brendshme*, që edhe pse ndihet i huaj, merr përsipër rrezikun e akuzave dhe fjalëve nga vendasit për gjestin që bën; b) *kohen që i dhuron*, merret disa ditë me të. Papa Françesku në enciklikën e tij të fundit: “*Vëllezër të gjithë*”, duke komentuar këtë pjesë thotë: “*në këtë periudhë që po jetojmë, me një rritje gati të shfrenuar, e kemi të kushtueshme kohen, dhe me shumë vështirësi arrijmë t'ia dhurojmë dikujt falas, duke prishur kështu interesat tona*”. Ndoshta është bamirësia më e veçantë t'i dhurosh dikujt kohën tënde, sepse në fund të fundit po i dhuron pjesë nga jeta jote, po tregon dashuri dhe respekt për të.

Të jetosh bamirësinë e krishterë sot nevojitet të hapesh sytë e të shohësh të plagosurit e ecjes sate, që nuk janë domosdoshmërisht ata të aksidentuarit e largët dhe të kronikave televizive, por të jesh i ndjeshëm ndaj personave që vuajnë shpirtërisht, njerëzisht e ndoshta më shumë se sa materialisht. Përballë këtyre situatave, vazhdon Papa: *“rrezikojmë që të jemi të përqendruar shumë mbi nevojat tona. Të shohësh dikë që vuan, me siguri që na shqetëson, na vë në siklet, sepse nuk duam të humbim kohë me problemet e të tjerëve. Këta janë simptoma të një shoqërie të sëmurë, sepse mendon të ndërtojë një kulturë që i sjell shpinën dhimbjeve”*. Në fakt, kjo është kultura që përjashton vuajtjen, duke idealizuar mirëqenien, përjashton kryqin duke jetuar një ringjallje artificiale.

Duke marr shkas nga kjo pjesë ungjillore, që patjetër na prek në ndërgjegje të gjithëve kur gjendemi përballë apelit të Krishtit në Ungjillin e Mateut 25, *“Çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjël, e bëtë për mua.”* Dëshiroj të ndalem në dy dimensionet klasike të jetës sonë kishtarë: *ad intra* dhe *ad extra*.

Bamirësia *ad intra*

I afërmi yt nuk është larg teje, është vëllai yt, madje herë-herë, je edhe vetë ti. Zakonisht ne jemi të prirur që kur bëhet fjalë për bamirësinë, të mendojmë dikë, larg e jashtë rrethit tonë që ta ndihmojmë. Por kam dëshirë që të ndalem pak e të shoh edhe një mënyrë të re të të kujdesurit *ad intra*, qoftë për kishë, njëri-tjetrin dhe për veten. Besoj se edhe Zotit i pëlqen kjo.

Kisha. Mendoj se kemi nevojë që herë pas herë të ngremë shikimin edhe përtej rrethimit të kishës sonë famullitare ose të kuvendit tonë. Të shohim e të ndiejmë me gjithë kishën. Besoj se hapi i parë është *kujtesa* apo *“anamnesi”* në gjuhën biblike. Kemi bërë shumë gjëra këto vite. Me siguri do të ishin bërë shumë më tepër, por nuk është e drejtë që me këtë logjikë të “pangopurës”, të humbet edhe ajo e mirë që realisht është bërë në kishën tonë e në dioqezën tonë. Mendoj se edhe kjo është një formë bamirësie që mund t'i japim botës, të falënderojmë Zotin, bamirësit e njëri-tjetrit për të mirat që kemi marrë e kemi dhënë në kishë. Nga *anamnesi* lind edhe *mirënjohja*. Ky kriter vlen edhe në aspektin shpirtërorë. Vetëm kur të kujtosht të mirat që Zoti ka bërë në jetën tënde, do të arrish ta falënderosh thellësisht Atë. Sa veprat të mira i bën secili në misionin e vet! E misioni i Caritasit, ndoshta është edhe ky, një kujtesë falënderuese për secilin që me mundë e sakrificë iu gjendeni pranë shumë të varfërve në mbarë dioqezën tonë me vepra e shenja të pranisë së Zotit që kujdeset për botën. Ndoshta ky

është ilaci më i mirë që shëron *kritikën ankuese* që vetëm dëmton, apo edhe mosngopjen e vazhdueshme që nuk di të ndalet e të falënderojë. Një ushtrim i mirë mund të jetë që para Zotit, t'i kalojmë ndërmend të gjitha këto dhe ta falënderojmë Atë, me gjithë zemër.

Njëri-tjetri. Aspekti i lartpërmendur kishtarë (*eklesial*), por edhe falënderues, ndikon shumë pastaj edhe në dy aspektet tjera, qoftë në atë relacional, si edhe na atë personal. Pa dyshim që forma më fisnike e bamirësisë në Kishë është edhe kujdesi reciprok për njëri-tjetrin, për Ipeshkvin, meshtarin vëlla, për motrën, për besimtarin. Kjo nuk do të thotë që të mbyllesh në rrethin e ngushtë, por të dish që ta shohësh “të afërmin” e parë që ke ndër sy, pa pasur nevojë të shkosh në një vend të largët. Ndoshta vetëm duke u kujdesur për këto “të afërm” mund të fillojmë të hyjmë në logjiken mishëruese të Ungjillit, që nuk lë jashtë asnjërin por secilit i gjendet pranë. Secili prej nesh ka ato “plagosjet” që janë shenjë e një përpjekjeje për të ecur, për t'u rritur, e shpresoj që nuk janë shenja të mëkatit. Por edhe nëse janë, është hir i Zotit, sepse Ai dëshiron të na kthejë e të na ndihmojë. Jemi “samaritanë të mirë”, jo vetëm ndaj mijërave personave që ju shërbejmë në spitale ose në famullitë tona, por le të jemi “samaritanë të mirë” edhe ndaj plagosjeve dhe dobësive të njëri-tjetrit. Të kemi shumë respekt për dinjitetin e secilit, të kemi shumë maturi ndaj fjalëve dhe (para)gjykimeve. Papa Françesku në enciklikën e tij: *“Vëllezër Të Gjithë”*, na kujton se *mirësjellja* dhe *respekti* i lirojnë marrëdhëniet njerëzore nga mizoritë e ndryshme e nga inatet.

Një ushtrim i mirë shpirtërorë dhe jo vetëm mund të jetë: lutja e vërtetë për njëri-tjetrin, vizitat, takimet e singerta, ndeshjet sportive, bashkëndarjet e ndryshme. (*krh. Kol. 3, 12-16*)

Vetvetja. Kjo ndoshta është forma e bamirësisë më e çuditshme edhe pse ne jemi edukuar me formën e shenjtë të dhurimit për të tjerët. Por efikasiteti i këtij dhurimi varet edhe nga dashuria, kujdesi, respekti që tregojmë edhe ndaj vetës. Ky nuk është egoizëm. Shpesh herë e marrim për të mirëqenë faktin se kemi kujdes për veten, por nuk mjafton vetëm ai kujdesi bazë fiziologjik, por duhet më shumë. Është e nevojshme që të mos harrojmë secili statusin e vet, thirrjen meshtarake dhe rregulltare, prandaj edhe përgjegjësia e kujdesit nuk është vetëm bazik, por duhet të jetë në proporcion edhe me statusin dhe shërbimin e shenjtë që zhvillojmë. Prandaj nuk duhet të harrojmë që të jemi bamirës edhe ndaj vetvetes: me kujdesin fiziologjik e shëndetësor, njerëzor dhe shpirtëror. Pastaj, është gjë e mirë dhe e shenjtë t'i japim vetës edhe

momente të denja argëtimi e pushimi në përputhje me dinjitetin e statusit tonë. Por edhe në këtë aspekt personal, është shenjë dashurie vëllazërore nëse e shohim një vëlla ose motër të shkujdesur. Shën Karlo Borromeo e porositë klerin e tij me këto fjalë: “A e ushtron kujdesin për shpirtra?! Por mos e lë pas dore kujdesin për vetën tënde, dhe mos iu jep të tjerëve deri në pikën që mos të mbetet asgjë ty nga vetja jote.

Bamirësia *ad extra*

Me siguri se i tërë misioni i Kishës është bamirësi, sepse bëhet vetëm për dashuri. Në të kundërt do të rrezikohej të ishte organizatë fitimprurëse. Është e rëndësishme edhe pikëpamja e jonë ndaj Kishës, dhe ndaj shërbimit tonë si njerëz të kishës. Në fakt nuk duhet të harrojmë kurrë se misioni ynë si kishë është një shërbim i cili si i tillë ka vlera ungjillore. Edhe Shën Pali, në fakt, kur flet për priftërinjtë parapëlqen të përdorë sinonimin “mbarështues” ose siç mund ta quajmë edhe ndryshe administrator edhe në gjuhën e sotme. Për këtë arsye ata përkufizohen nga ai si “shërbëtor të Krishtit dhe mbarështues të mistereve të Hyjit” (krh. 1 Kor 4, 1).

Mendoj se këta dy terme janë udhërrëfyesit tanë: *shërbim* dhe *bamirësi*, ose të shërbesh falas, me dashuri. Jam i bindur se po të shikojmë pak veprat dhe njerëzit që kemi ndihmuar do të ishim shumë mirënjohës për të mirat që kemi bërë.

Tani po jetojmë në një kohë të pazakontë për shkak të pandemisë, ku varfëria është më e dukshme dhe më e prekshme. Për këtë arsye edhe Papa Françesku në mesazhin e tij të përvitshëm kushtuar Ditës Botërore të të Varfërve, e ka titulluar “*Shtrija dorën tënde të varfrit*” (krh. Sir 7,36), që do të kremtohet të dielën e XXXIII, pra me 15 nëntor. Ja çfarë na porositë Papa: *T’ia shtrish dorën: është një shenjë që na kujton menjëherë afërsinë, solidaritetin, dashurinë. Në këto muaj ku e tërë bota është prekur nga një virus i cili ka shkaktuar dhimbje dhe vdekje, pikëllim e shqetësim, sa duar të shtrira kemi parë! Dora e shtrirë e mjekut që përkujdeset për pacientin duke u përpjekur të bëjë më të mirën. Dora e shtrirë e infermierit, që edhe pse jashtë orarit të punës, është e gatshme për të*

mjekuar të sëmurët. Dora e shtrirë e punëtorit që përkujdeset në punë të ndryshme për të siguruar jetën e sa e sa njerëzve. Dora e shtrirë e meshtarit që bekon me gjithë zemër. Dora e shtrirë e vullnetarit që u shërben atyre që jetojnë nëpër rrugë, të cilët edhe pse kanë një shpi, por nuk kanë për të ngrënë. Dora e shtrirë e burrave e grave që ofrojnë shërbimin e tyre thelbësorë e të sigurt.”

Edhe ne, si Kishë, jemi të përfshirë në të gjitha këto vepra bamirësie. Është e rëndësishme që edhe si bashkësi famullitare ta mbajmë gjallë ndjeshmërinë e popullit tonë ndaj atyre që kanë më shumë nevojë. Për këtë arsye kemi menduar që të fillojmë me rrjetin e vullnetarëve të Caritasit dioqezan që të formojmë njerëz që të kenë ndjeshmëri dhe gatishmëri për t’iu gjetur pranë famullitarit në shërbim ndaj personave në vështirësi. Gjithashtu edhe nisma e *muajit të bamirësisë* (15 nëntor-13 dhjetor), ka për qëllim sensibilizimin e besimtarëve ndaj më të varfërve. Jam i bindur që këto e shumë vepra të mira

bamirësie po bëjmë, por është më efikase nëse i bashkërendojmë. Vetëm në këtë mënyrë e luftojmë kulturën e mospërfilljes siç e thekson edhe Papa: “*Shtrija dorën tënde të varfrit*”, *bën që të shpërthejnë ata të cilët i mbajnë duart e veta në xhepa dhe nuk mallëngjehen nga varfëria, ku shpesh herë janë edhe shkaktarë të saj. Mospërfillja dhe tallja janë ushqimi i tyre i përditshëm. Është krijuar kështu një globalizim mospërfilljeje, vetëm me vetëm për të mbajtur një stil jete që i përjashton të tjerët. Gati pa e vënë re, bëhemi të paaftë për ta ndier britmën e dhimbjes së të tjerëve; nuk qajmë më nga drama e tjerëve dhe as nuk kujdesemi më për to, sikur të mos ishte një përgjegjësi e jona që na takon neve”* (Nxitja Ap. Gëzimi i Ungjillit, 54).

Na shoqëroftë Nëna e Tenzot, që më shumë se gjithçka është edhe Nëna e të Varfërve. Virgjëra Mari i njeh nga afër vështirësitë dhe vuajtjet e atyre që janë të mënjanuar, sepse vetë ajo ka sjellë në dritë Birin e Zotit në një shpellë.



Moter MARJETA GJOKA

*Punetore e Vogel e Zemrave të Shenjta***"SHEN JOZEFI", NJË SHENJT PËR TU RIZBULUAR**

«[...] Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuaren tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zë për virtyt të Shpirtit Shenjt» (Mt 1, 20).

Shen Jozefi është një nga Shenjtërit që nuk duhet të lihet në harresë, një Shenjt i cili ka një rëndësi shumë të madhe në Shkrimin Shenjtë e mbi të gjitha në historinë e shpëtimit, edhe pse mungon një njohuri e duhur mbi figuren dhe rolin e tij.

Në historinë e Kishës nuk mungon kurr veprimi i Shpirtit Shenjt, pikërisht edhe në këtë rast ishte shumë e rëndësishme të mos mbetej kjo figurë me një vizion sipërfaqësor, që do të thotë, thjesht të kemi një dëvotshmëri për Shen Jozefin. Figura e këtij Shenjti meriton të kuptohet në thellësi, e që ta kuptojmë na nevojitet të rishikojmë jetën e tij dhe ta rizbulojmë.

Perspektiva e sotme për Jozefin është shfaqja gjithnjë e më e qartë e një karakteri, i cili shquhet qartë dhe më domethënës për rolin e tij si pranimision i jetës, i rrënjës drejtpërdrejt në misterin e madh të Krishtit dhe të Kishës: «Ai bashkëpunon në plotësinë e kohës në misterin e madh të shpengimit dhe është me të vërtetë një ministër i shpëtimit», (Nxitja Apostolike *Redemptoris Custos* nr. 8). Megjithatë, përkundër titullit të shquar dhe mirënjohjeve autoritare që ai ka në kontekstin e liturgjisë, të reflektimit teologjik dhe në dëvotshmërinë e Kishës, duket që në ditët e sotme figura e Shen Jozefit nuk ndihet aq shumë, nuk



Në shkrimet e etërve të Kishës vërejmë që ato janë përpjekur shumë për të kuptuar kush është

Jozefi, dhëndëri i Virgjëres Mari, babai i Jezusit, biri i Davidit dhe njeri i drejtë? Kjo është pyetja që gjatë mijëvjeçarit të parë të historisë së krishterë haset në shumë shkrime të ndryshme, të etur për të njohur dhe mbrojtur dinjitetin dhe historinë e jetës së Shen Jozefit. Ajo që zbulojmë mbi figuren e Shen Jozefit është se, ai është shembull dhe garanci e besnikërisë historike dhe e i frytshëmërisë shpirtërore, nuk është një figurë e heshtur dhe e shurdhër, por në historinë e shpëtimit ka një rol të rëndësishëm dhe shumë të gjallë.

është më shumë e pranishme, duket sikur të jetë pa incizivitet. Mungon një njohuri e përshtatshme dhe një kuptim i ripërtërirë i figurës njerëzore dhe rolit të tij: pothuajse një errësi, ku lihet në harresë dhe pa vendosur në dukje vlerat e tij unike shpirtërore. Për një njohuri më të mirë mbi figuren e Shen Jozefit, na kërkohet një analizë e ripërtërirë dhe një rilexim i azhurnuar i Fjalës së Hyjit, sepse nuk mund ta njohim jashtë Shkrimit Shenjtë e pikërisht e njohim atë në një lidhje të ngushtë me misionin shpëtimtar të Birit të Hyjit, siç vërehet mbi të gjitha na kërkohet një reflektim teologjik.

Shën Jozefi në Ungjij

Jezusi Mesi

Siç u nënvizua edhe më sipër figura e Shen Jozefit kja një lidhje me veprën mesianike të Jezusit, nëse do rishikojmë ungjijt figura e këtij Shenjti gjendet aty. Duke u nisur nga hyrja e ungjillit të Gjonit na e paraqet Jezusin në një vizion unik.

Nga njëra anë, ai ndalet në lartësimin e Fjalës i cili na thotë: «Në fillim ishte Fjala e Fjala ishte Hyj. Kjo ishte në fillim në Hyjin. Prej saj u bë çdo gjë e pa Të nuk u bë asgjë. E çdo gjë që u bë, e pati në Të jetën e Jeta është drita e njerëzve», (Gjn 1, 1- 4); nga ana tjetër, ungjilltari pohon zbritjen e së njëjtës Fjalë, e cila «Fjala u bë njeri e banoi ndër ne» (Gjn 1, 14), duke e manifestuar vetvetën si Biri i Hyjit.

Po ashtu edhe dëshmia e madhe e Gjon Pagëzuesit, na e paraqet Jezusin si Drita e vërtetë që do ndriçojë çdo njeri (Krh. Gjn 1, 7) dhe Gjon Pagëzuesi vazhdon duke na dëshmuar që: «Ky është Biri i Hyjit» (Gjn 1, 34), siç vërehet në atë çfarë na paraqet ungjilltari na len përshtypjen se diçka bën kontrast, duke integruar përshkrimin teologjik me atë historik. Në vazhdimësi ungjilltari na paraqet edhe dëshminë e përvuajtur të Filipit apostull, i cili ishte një bashkëqytetar i Andresë dhe Pjetrit, dhe ai duke u takuar me Natanaelin i thotë: «E gjetëm atë, për të cilin shkroi Moisiu në Ligj dhe Profetët: Jezusin, birin e Jozefit, nga Nazareti» (Gjn 1, 45). Në këto fjalë të fundit kemi atësinë dhe vendin e lindjes, atë që mund të përcaktojmë statusin e regjistrit të Jezusit, birit të Hyjit i bërë njeri. Nëse besimi i mundësoi Gjon Pagëzuesit të identifikonte Jezusin si Biri i Hyjit, në sytë e botës Jezusi njihej thjesht si «biri i Jozefit, nga Nazareti». Çfarë reagimesh ngjalli kjo atësi dhe origjinë tek njerëzit? Ungjilltari nuk na e lë një mister, por na vendos në dukje atë çfarë mendonin mbi Jezusin aq më shumë mbi prejardhjen dhe atësinë. Kur Jezusi pohonte duke thënë: «Unë jam buka e gjallë që zbriti nga qielli», hebrenjtë kishin krahasuar përvojën e tyre, dhe thonin: «Vallë, a nuk është ky Jezusi, biri i Jozefit? Po, a nuk ia njohim babën e nënën? Si mund të thotë tani: Kam zbritur prej qiellit?» (Gjn 6, 42). Edhe në Nazaret bashkëvendasit e tij mrekulloheshin me fjalët që i dilnin nga goja dhe thonin: «Vallë, a nuk është ky biri i Jozefit?» (Lk 4, 22); « Po a nuk është biri i zdrukthëtarit?» (Mt 13, 54). E kjo u shkaktonte mosbesim në të, (Mt 13, 57). Përshtypja se emërimi i Jezusit si «Nazarenas» nganjëherë lidhet me një ndjenjë përbuzjeje dhe armiqësie, (krh. Mk 1, 24;

14,67; Lk 4,34; Mt 26,71; Vap 22, 8; 24, 5; 26, 9) konfirmohet nga tekste të qarta. «Disa prej popullit kur i dëgjuan këto fjalë, thoshin: Ky është më të vërtetë Profeti! Tjerë thoshin: Ky është Mesia! Prap do tjerë thoshin: Vallë, a prej Galilesë do të dalë Mesia? Po a nuk thotë Shkrimi Shenjt se Mesia vjen nga pasardhësit e Davidit, mu nga Betlehemi, prej vendit nga ishte Davidi? Kështu u bë përçarje në popull për shkak të tij» (Gjn 7, 40-43). Të njëjtin mendim dhe të njëjtën vështirësi ndanin farisenjtë, të cilët iu përgjigjën Nikodemit, ndërsa ai po përpiquej të mbronte Jezusin: «A mos je edhe ti prej Galileje? Hulumto e do të shohësh se prej Galileje nuk ngritet profet!» (Gjn 7, 52). Natanaeli nuk kishte qenë në gjendje të fshehtë gjykimin e tij të pafavorshëm për Nazaretin, dhe për këtë i thotë Filipit: «A mund të dalë gjë e mirë nga Nazareti?» (Gjn 1, 46). Nga këto dëshmi duket se origjina e Jezusit ishte nga Nazareti, «atje ku ishte rritur» (Lk 4,16). Ai kishte errësuar, në mentalitetin e turmës, vendin e tij të vërtetë të origjinës, Betlehemin dhe lindjen e tij të ligjshme davidike. Luka me përpikmërinë e tij si historian, informon marrësit e ungjillit të tij rreth shpalljes që ndodhi në Nazaret, rasti i transferimit të Familjes së Shenjtë në Betlehem, ku ka lindur fëmija, dhe kthimi në Nazaret, duke zgjidhur kështu problemin e lokaliteteve të ndryshme. Ai, gjithashtu, kënaqet në përshkrimin e konceptimit të mrekullueshëm të Jezusit, i sigurt për interesimin dhe kënaqësinë e lexuesve të tij. Nga ana tjetër, Mateu, e konsideron problemin e lokalitetit si një përfundim të paramenduar, duke e futur atë në bisedën e dijetarëve me Herodin (Krh. Mt 2, 2-7) dhe drejtpërdrejt paraqet Jezusin si «të lindur në Betlehem të Judesë» (Mt 2, 1). Nazareti përmendet vetëm pasi të kthehet nga Egjipti. Duke kapërcyer kështu vështirësinë e prejardhjes së Jezusit, Mateu, duke shkruar për Judeo - të Krishterët, ai është më shumë i shqetësuar për problemin e mesazheve të Jezusit, duke i kushtuar shumë kujdes fjalëve dhe mësimëve të Tij, i vështirë për tu pajtuar për lexuesit e tij, mbi prejardhjen davidike. Në fakt, nëse rrethanat e konceptimit virgjëror nga njëra anë lartësojnë kalimin e Jezusit, nga ana tjetër, duke përjashtuar bashkëpunimin e farës së Davidit, nuk garanton të drejtën e Jezusit për premtimet davidike. Mateu pastaj nënvizon se si ishte vetë Zoti që siguroi legjitimitetin e prejardhjes davidike të Jezusit, pasi shprehimisht, përmes një engjëlli, ai donte t'ia caktojë atësinë e tij «birit të Davidit» Jozefit (Krh. Mt 1, 18-25). Nuk ishte një njeri, por ishte vetë Hyji, ai i cili e bëri të hyj Jezusin në

mënyrë të virgjër në familjen e Davidit. Siç vihet re nga vetë pohimi është e qartë që çdo gjë i përket iniciativës Hyjnore, Mateu njëkohësisht garanton në nivelin historik rolin e duhur të Jozefit, i cili ka bërë të mundur që Jezusi të quhej biri i Davidit, duke e siguruar ligjërisht atë për pasardhësit e tij. Një pasardhës i tillë ishte një shenjë e Mesisë, më e rëndësishme të paktën në sytë e hebrenjve, sesa konceptimi i virgjër; nga ana tjetër, edhe për faktin nëse Maria vinte apo jo nga shtëpia e Davidit nuk kishte aspak rëndësi për pasardhësit e Jezusit (Krh. Lk 1, 5. 36). Jozefi nuk ishte, pra, një figurë dytësore në ngjarjen e madhe të lindjes së Shpëtimtarit, por ai kishte një pjesë të vërtetë, pozitive dhe të rëndësishme në të, por të ndryshme me atë të Marisë. Ungjilltarët Mateu dhe Luka pajtohen të paraqesin Shen Jozefin si pasardhës të prejardhjes së Davidit (Mt 1, 1-16.20; Lk 1, 27; 2,4; 3,23-31); përkundrazi, ata ndryshojnë në gjenealogji, secili duke ndjekur një seri të ndryshme paraardhësish, të cilët tek Mateu arrijnë te Jozefi përmes Jakobit (Mt 1, 16), te Luka përmes Helit (Lk 3, 23). Nazareti është vendi ku Luka (Lk 1, 26), gjithashtu vazhdon duke na prezantuar me Jozefin i cili ishte i fejuar me një virgjër të quajtur Mari, e cila e lajmëruar nga engjëlli Gabriel që: «Shpirti Shenjtë do të zbrësë në të e fuqia e Hyjit të tejetlartë do të mbulojë me hijen e vet; prandaj ky Fëmijë do të jetë i Shenjtë – Biri i Hyjit» (Lk 27-35). Për shkak të një dekreti të Cezar Augustit, i cili përshkruan një regjistrim, familja shkon në vendin e tyre të origjinës, në Betlehem, ku lindi Jezusi (Krh. Lk 2, 1-7). Ndërsa Luka tregon konceptimin dhe lindjen e Jezusit duke nënvizuar virgjërinë e Marisë, Mateu, nga ana tjetër, i cili shkruan për hebrenjtë, nënvizon mesianismen e Jezusit, birit të Davidit. Për këtë qëllim, ai fillon Ungjillin e tij me fjalët: «Breznitë e Jezu Krishtit, të birit të Davidit, të birit të Abrahamit» (Mt 1, 1) dhe vazhdon duke rënditur derisa arrin tek Jakobi të cilit i lindi «Jozefi, fati i Marisë, prej së cilës leu Jezusi që quhet Krisht» (Mt 1, 16). Për këtë prejardhje ligjore, të pohuar nga gjenealogjia, Mateu pastaj rrëfen se si u realizua lindja e Jezusit, dhe shprehet kështu: «lindja e Jezu Krishtit ndodhi kështu» (Mt 1, 18). Në këtë rast qëllimi i Mateut është për të aprovuar atësinë ligjore të Jozefit, pikërisht për këtë ai vazhdon me rrëfimin e tij duke vënë në dukje figuren e Jozefit e mbi të gjitha rëndësinë e tij që do kishte për të mikëpritur Birin e Hyjit dhe për tu kujdesur për të. E gjithë kjo, Jozefit i zbulohet nëpërmjet mesazhit të engjëllit, dhe bëri ashtu siç i tha ai në ëndërr (Krh. Mt 1, 18-25). Mateu, në fakt,

kishte deklaruar në mënyrë të qartë se «Maria, nëna e tij, pasi u fejuar me Jozefin, para se të banonin së bashku, u gjet shtatzënë për virtyt të Shpirtit Shenjt», në nivelin juridik se si do lindë fëmija i konceptuar në një mënyrë të virgjër, bëhet çështje serioze e trashëgimisë në fronin e Davidit. Kjo vështirësi pasqyrohet nga Mateu, sepse Jozefi gjendet përpara ndonjë pyetje: a mund ta mbajë akoma Marinë legalisht si gruan time, sepse siç na e ka prezantuar Mateu, Maria tashmë i përket Hyjit?



A i lejohet t'i japë emrin Fëmijës, që ishte i ngjizur në krahërin e Marisë për virtyt të Shpirtit Shenjt? Mateu na paraqet se pytet e Shen Jozefit marrin përgjigje nga engjëlli, «Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuaren tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. Ajo do të lindë djalë e ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbtojë popullin e vet prej mëkateve të tija» (Mt 1, 20-21). Vërehet qartë që Jozefi ka një detyrë të rëndësishme për të përmbushur, edhe Papa Gjon Pali II shprehet

kështu: «Shen Jozefi u thirr nga Hyji për t'i shërbyer drejtpërdrejt personit dhe misionit të Jezusit përmes ushtrimit të atësisë së tij», (Nxitja Apostolike *Redemptoris Custos*, nr. 8). Ai veproi si baba i vërtetë duke u kujdesur shumë për Jezusin, po ashtu, pa harruar edhe kujdesin e madh që Jozefi kishte edhe për Marinë.

E gjithë kjo cituar më sipër është një pasqyrim i lindjes së Jezu Krishtit ashtu si na e prezanton ungjilltari Mateu. Ndërsa në historinë e lajmërimit tek Luka kemi diçka të vecantë, po ta lexojmë me kujdes bie në sy shumë shpejt, është detyra që engjëlli i jep Marisë: «Ja do të mbetesh shtatzënë dhe do të qitësh në dritë një djalë dhe ngjitja emrin Jezus» (Lk 1, 31), në këtë rast, në angazhimin që engjëlli i jep Marisë mbi vendosjen e emrit ai përdor një formë jopersonale: «Kur u mbushën tetë ditë për të rrethprerë Foshnjën, ia ngjiten emrin Jezus, sikurse e quajti engjëlli para se të zihej në krahavor» (Lk 2, 21). Nga ana tjetër, Mateu thotë qartë se ishte Jozefi ai që e quajti Jezus, (Krh. Mt 1, 21; Mt 1, 25). Bëhet fjalë për ushtrimin e autoritetit atëror. Dyzet ditë pas lindjes, Jozefi shoqëron Marinë dhe Jezusin në Jeruzalem, ashtu sic ligji e kërkonte për pastrimin e tyre dhe për të paraqitur Jezusin në tempull për të kushtuar të parëlindurin, po ashtu Jozefi dëgjon me habi se si shprehet Simoni kur merr Jezusin para duarsh dhe falenderon Hyjin duke thënë: «Tani, o Zot, mund të lejosh të vdesë shërbëtori yt në paqe sikurse the ti vetë, sepse me sytë e mi e pashë shëlbimin që ti e bërë gati në sy të të gjithë popujve» (Lk 2, 29 - 32). Nuk mund të harrojmë viziten që dijetarët i bënë Jezusit në Betlehem dhe të mësuar nga Hyji në ëndërr të mos ktheheshin tek Herodi u kthyen një rrugë tjetër në vendin e vet. Pas largimit të dijetarëve, engjëlli i Zotit iu dëftua në ëndërr Jozefit e i tha: «Çohu, merre fëmijën dhe t'ëmen e tij e ik në Egjipt. Rri atje deri që të them unë, sepse Herodi do ta kërkojë fëmijën për ta vrrarë» (Mt 2, 13-14).

Shen Jozefi kreu i Familjes së Shenjtë

Mateu i cili na ka paraqitur historinë e dyshimit të Jozefit, vështirësinë e atësisë së tij në një nivel juridik, duke e njohur «birin e Davidit» pushtetin mbi Marinë dhe djalin e saj, tani na tregon në ushtrimin e të drejtave të tij dhe funksionet e tij si kryefamiljar i Familjes së Shenjtë. E atij që engjëlli i shfaqet; është për të që engjëlli flet; destinacioni i komunikohet atij; është për të që data e riatdhesimit do të zbulohet. Jozefi është kryetari i padiskutueshëm i shtëpisë së tij, në të cilën gjithçka i nënshtrohet: «Merrni fëmijën dhe nënën e tij»

(Krh. Mt 2, 13-20). Qëndrimi i Familjes së Shenjtë në Egjipt zgjati deri në vdekjen e Herodit (Krh. Mt 2, 19), që ndodhi në vitin 750 të Romës. Herodin e Madh e pasuan tre djemtë e tij: Arkelau, Antipa dhe Filipi. Arkelau, i cili kishte marrë titullin e etnarkut, kishte prekur Samarinë, Judenë dhe Idumenë. Karakteri i tij mizor dhe hakmarrës dhe përmbushja e një profetie janë arsyet e dhëna nga Mateu (Krh. Mt 2, 22) për zgjedhjen që Jozefi bëri si vendbanimi i Familjes së Shenjtë, të Nazaretit në Galile, një vend i caktuar nga engjëlli, ky vend ishte i qeverisur nga tetrarku Herod Antipa. Luka na thotë që: «pasi kryen gjithçka duhej bërë sipas Ligjit të Zotit, u kthyen në Galile, në qytetin e vet, Nazaret» (Lk 2, 39). Ne gjithashtu e dimë nga Luka se Jozefi shkonte me familjen e tij çdo vit në Jeruzalem për të kremten e Pashkëve (Krh. Lk 2, 41) dhe se, pikërisht në këtë rrethanë, Jezusi dymbëdhjetë vjeçar u ndal pa dijen e prindërve të tij, duke menduar se ishte në turmë ecën një ditë por kur vënë re që nuk ishte as me të afërmit, zunë ta kërkojnë dhe pas tre ditësh e gjeten në Tempull mes dijetarësh duke dëgjuar ato dhe duke ju bërë pyetje, (Krh. Lk 2, 42-50). Dhe përsëri Luka ai që përcakton gjithë jetën e Jezusit në Nazaret duke theksuar se: «ai ishte i dëgjueshëm» ndaj prindërve të tij (Lk 2, 51).

Kualifikimi që merr vepra e Jozefit është ai i «zdukthëtarit» (Mt 13,55; Mk 6,3), një shprehje e përkthyer nga Vulgata si "*faber*". Natyra e përgjithshme e termit lejon që ajo të shtrihet në shumë aktivitete manuale.



Don Nosh GJOLAJ

CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS DUHET TË RESPEKTOHET

(Pjesa e katërt)

Të jesh me tjetrin do të thotë ta përjetosh e ta shijosh atë!

Njeriu i sotëm zakonisht është mjaft i tjetërsuar nga bota virtuale, dhe fatkeqësisht nuk di më të shijojnë, ajrin e pastër, natyrën, lindjen apo perëndimin e diellit, ushqimin natyral, takimi me tjerët, mos të themi me çiftin martesor. Mjaft individë sot vuajnë nga nacisi. Po qe se jetojmë me tjetrin posaçërisht në bashkësinë martesore, e nuk mund me të të jetojmë, por përherë në luftën e pamëshirshëm për çdo gjë, edhe në më të vogël gjë reagojmë në mënyrë paniku apo histerike. Kuptohet jeta e tillë nuk i përngjan më dashurisë dhe idealit të martesës, por një ferrit në kuptimin e fjalës. Por në rastet e tilla duhet ta shfrytëzojmë psikologjinë e pasqyrës. Se njeriu zakonisht nuk e sheh pasqyrën por veten. Ato gjëra që ja dedikojmë atij, jam unë që e shoh veten nëpër mes atij tjetrit, kurse tjetri është pasqyrë. Madje duhet të vihem në lëkuren e tjetrit. Derisa këtë nuk e bëjmë, gjithherë do të jemi kundërshtar që nuk mund të harmonizohet ritmin e jetës. Kuptohet vetvetiu se dy veta nuk mund të njëjtën kohë të qëndrojnë në të njëjtin vend.

Jeta është mjaft e gërshetuar qoftë me kërkesa, qoftë me dëshira, qoftë me peri peti, që gjithherë kërkojnë jo vetëm korrigjime por edhe kompromis, përndryshe jeta e përbashkët është e pamundur. Në rendin e parë duhet ta përjetojnë tjetrin, situatën e tij, zanafillën e shpirtin e tij. Jo vetëm ta përjetosh por edhe ta pranosh ashtu siç është me të cilin jeton së bashku, e nda fatin e dashurisë edhe pse nuk përputheni në karakterin tënd, temperament, në pikëpamje apo mendësi siç është fjala në ritmin e jetës.

Zakonisht nënat janë mjeshtër i mirë për ta përjetuar fëmijën e vet. Për këtë e kanë aftësitë e durimit me një farë ndjeshmërie i afrohen fëmijës e me gatishmëri emocionale e kureshtare e shoqërojnë fëmijë edhe pse ai është kokëfortë, i bezdisshëm me pyetje e shumta: “pse” këta apo ata. Nëna di aq bukur dobësitë e mungesat e fëmijës për t’i arsyetuar.

Diçka e tillë është e mirëseardhur edhe në gjirin martesor. Po qe se dëshirojmë ta kursejmë hidhërimin, brengat, ankthin, pasigurinë e dhimbjet, atëherë duhet të sjellim siç sjellët prindi ndaj fëmijës e ta përjetojmë tjetrin ashtu siç është në

realitet e të njëjtën kohë të zhvillohemi e ta ruajmë identitetin e pacenuar, që nuk është asgjë tjetër përveç pjekuria individuale jo vetëm fizike por edhe psikike e shpirtërore.

Fëmija e pafajshëm zakonisht e kanë këtë intuitë. Si fjala bie, nga shembulli që vijon: fëmija kthehet nga komshiu i tyre, e pyet mami: “Mami, pse fqinja më do aq shumë e gjithherë sjellët me mua në njëfarë mirënjohje e butësi?” Nëna, posa i jepet rast e pyet fqinjën për mirësjelljen ndaj fëmijës së saj. Ajo i përgjigjen: “Pas që më vdiq burri e menjëherë pas tij vdiq edhe i vetmi fëmijë, isha krejtësisht e tmerruar, e dëshpëruar thuajse e humbur pashpresë në dhomën time. Atëherë erdhi vajza e juaj nëpër derë e hapur, e kur e vërejtë se qasha, ajo afrohet afër meje, e filloi të më përkëdhelin faqen time të lagur nga lotët po ashtu edhe ajo filloi të qajnë me mua. Aq më preku mirësjellja e solidariteti i saj sa që ma largoi mërzinë, dëshpërimin e pikëllimin e tmerruese, e mu riktheje shpresa e humbur. Unë nuk mund t’ia harroi këtë nderë që ma solli bija e juaj, ndoshta nuk jam mjaft e mirësjellshme ndaj saj!”

Ndoshta na duke e vogël një gjest i tillë por pason përvojat e pashlyeshme, që partnerët kur nuk bënë ta harrojnë, po qe se e përjetojmë tjetrin në veçanti në brenga, dëshpërimi, në ankth e frikës apo edhe në gëzim, ato mbesin gjithherë të pashlyeshëm e të pa harruara, po ashtu të rikthehen me mirënjohje të pashoqë. Nganjëherë kërkohet e pamundshmja, që nuk mund të realizohet, ose kërkohet gjërat e parealizueshme, që nxitë fajësimin e tjetri për paafësinë, për përtaci, për ngelje e për pakarakter e ashtu me radhë. Nganjëherë edhe mënyra se si ia paraqesim tjetrit nevojat apo kërkesat tona mund të jenë fyese mos të themi e lëndojmë atë tjetrin, ashtu ai tjetri e përjeton njeriun e tillë si tiran, kokëfortë, të pagdhundur, edhe pse ndoshta e ka vullnetin e mirë, por ai nuk di ndryshe t’i shprehi mendimet apo nevojat e veta.

Për këtë arsye është mirë ta përjetosh e ta shijosh partnerin e tillë e ashtu siç është edhe me siguri do t’ia pushtosh zemrën e tij.

Por kuptohet çdoherë e kurdoherë identiteti, uni apo individi nuk shkrihet as nuk humbet në tjetrin, por mënyra apo rruga më e mirë është për të depërtuar në zemrën e tjetri, përjetimi, shijimi dhe hyrja në lëkuren e tjetrit. Sigurisht as suksesi nuk

do të mungojnë. Çifti martesor duhet gjithherë të bëhet vigjilent dhe të vetëdijesohemi, se aj tjetri është dikush tjetër dhe jo unë, bile as dy binjak të një qelize nuk përjetojnë as nuk shijojnë një lloj as nuk mendojnë një lloj, atëherë mos presim prej atij tjetrit të mendon si mendoj unë apo si përjetoj unë apo si shijoj unë. Po ashtu dëshirat janë diçka tjetër, e diçka tjetër është realiteti, që kërkon prej partnerëve që të harmonizohen e ta gjejnë rrugën e përbashkët për t'ia arritur qëllimin e jetës, që nuk është asgjë tjetër përveç dashuria e afatgjatë. Kjo është ai themeli i një pjekuri jo vetëm individit si të tillë por edhe çiftit martesor.

Siç dëshiroj unë t'i realizoj dëshirat apo aspiratat e mia po ashtu edhe ai tjetri konkretisht partneri dëshiron t'i realizoi dëshirat e tija. Prej kësaj rrjedhë diçka e natyrshme e spontane nga individ i mirë, që e ka identitetin e formuar e po ashtu pikëpamjet e jetës të shëndosha, ai si i tillë do të mundohet për t'i ndihmuar edhe tjetrit në rastin tonë partnerit për t'i realizuar dëshirat apo veten e vet. Ky urdhër është i pari dhe baza prej kah do të ecim përpara dhe vlen si për burrin ashtu edhe për gruan.

Urdhri i dytë rrjedh nga i pari, po qe se jam pak i kujdesshëm, nuk do të kërkoj nga partneri që të fijohet për mizat e mia, për t'i realizuar dëshirat e mija vetjake, apo të përshtate mua sipas kornizave që unë i diktoj.

Ja si e paraqet një tregim i imagjinuar, dialogun mes kafshëve të egra. Ku na ishte një herë kur kafshëve të pylli iu ra në veshë, se ariu kishte vendos ti mbysin kafshët, dhe i kishte bërë qitapin e kafshëve që do ti ngrënin. Kjo gjë i frikësoi shumë kafshët e pyllit, që jetonin një farë ankthi e pasigurie. Pas një kohet dreri nuk mund të durohet, shkoi te ariu për ta pyetur, a është e vërtetë për këtë gjë që bisedohet në mesin e kafshëve të pyllit. "Ari,

kam dëgjuar se i ke bërë listën e kafshëve që do ti ngrëniesh." "Po" i përgjigjet ariu. "A jam unë në mesin tyre?" pyet dreri

"Po!" përgjigjet ariu.

Të nesërme dreri u gjet i ngordhur.

Pas drerit, ujku mori guximin dhe shkoi te ariu:

"Ari, unë kam dëgjuar se e ke bërë një regjistrin i kafshëve që do ti grenësh?"

"Po, e vërtet" përgjigjet ariu.

"A jam edhe unë në mesin e tyre"? vazhdoi ujku.

"Po" i përgjigjet ariu.

Ditë e tjetër u gjet ujku i ngordhur.

Tani vendosi të shkoi te ariu lepurushi.

"Të përshëndes i dashuri Ari! A jam edhe unë në listën e regjistrimit tënd?"

"Po" i përgjigjet ariu.

"Të lutem a mundesh të më çregjistrosh nga qitapi yt?"

"Po. Nuk ka problem" dhe Ariu e çregjistroi lepurushin.

Duhet të merremi veshë thonë njerëzit. Nëpërmes bisedës apo dialogut shumë gjëra mund ti zgjidhi në jetën e përditshëm veçanti në bashkësinë martesore. Sa e sa shumë mosmarrëveshje janë qofshin ato në gjirin familjar, mes prindërve dhe fëmijëve, mes burri e gruas, në vendin e punës, në rrethin ku jetojmë. Të gjitha mosmarrëveshjet e konfliktet krijohet, se ne nuk dimë të merremi veshë, nuk dimë të bëjmë dialog. Shpeshherë gjërat e konfliktit i shtypim, mbesim komfort që herët a vonë hakmerren. Një bisedë mund ta shpëtojmë jetën, kurorën e martesë, familjen, fëmijën, vendin e punës apo diçka tjetër...

Gjithherë duhet çifti martesor ta kuptojë se flijimi duhet të jetë i vullnetshëm, i natyrshëm, spontan pa ndonjë imponim apo kusht. Përmbajta e ligjit nuk është flijim por obligim, po ashtu edhe jeta e përbashkët në gjirin martesor nuk duhet të mbretëroi vetëm obligimi

por arsyeja e dashurisë që dhurohet falas dhe pranon dhuratën po ashtu falas pa obligime, një gjë të tillë duhet të përjetohet, të shijohet duke e përjetuar e shijuar edhe shpirtin e tjetrit ashtu siç është, në këtë mënyrë do të harmonizohen dallimet, pikëpamjet, ritmi i jetës dhe shumë e shumë gjëra tjera, e ashtu do të kursejnë jo vetëm shëndetin, freskinë, por edhe dashuria do të ngritët e do të fisnikërohet edhe më tepër!



TË JETOSH NË TË MUND SHMEN

Arti në dialog - Luigi Territo S.I.

Veprat e arkimandritit Zinon janë konsideruar sot një nga trashëgimitë më të rëndësishme të artit liturgjik oriental bashkëkohorë. P. Zinon ka mundur të transmetojë trashëgiminë mjaft të pasur të artit bizantin përmes një dialogu, që mund të përfshijë tradita ikonografike të ndryshme. Në punën e tij gërshetohen historia artistike dhe ajo liturgjike të kishës lindore dhe perëndimore.

Nga zbulimi i rrënjëve bizantine të ikonografisë ruse deri te veprat më të fundit të frymëzuara nga tradita paleokristiane romane, P. Zinon ka mundur që të krijojë një sintezë të artistike duke e përvetësuar mësimin e kryeveprave mozaike të Ravenës dhe të pikturave të mbështjellë me traditë latine dhe egjiptiane.

I lindur në Ukrainë, më 1953, p. Zinon, ka studiuar në Insitutin e Artit të Odesës dhe më 1976 ka hyrë në manastirin e Grotte di Pskov, për t'ia dedikuar tërësisht jetën e tij Zotit dhe artit të shenjtë. Më 1996 është pezulluar për 6 vite nga të qenit meshtar, pasi ka komunikuar përgjatë një celebrimi eukarisik katolik, në Shkollën Ikonografike të Seriatit, me të cilën kishte kohë që bashkëpunonte. Përgjatë këtyre viteve p. Zinon u kthye në fshatin e Gverzdon, në kufi me Estoninë, dhe së bashku me një komunitet të vogël murgjish, ka vazhduar që të pikturojë për komisione private. Pasi u fut me kohë të plotë në kishën ruse, mes nëntorit të 2006 dhe shtatorit 2008, asistuar në një skuadër ikonografësh, ka rifreskuar katedralen rose-ortodokse të Shën Nikollës në Vjenë. Në 2013 ka përfunduar afresket e kishës inferiore të Fedeorovskiy në Shën Peterburg, frymëzuar nga mozaikët e Shën Apollinarit të Ri të Raventës dhe të pikturës romane të shekujve të parë të krishtera. Eksperimentimi artistik i p. Zinon merr frymë shpirtin e të shenjtës liturgji, e lë veten të përshkohet nga një shikim besimi, i iluminuar nga një jetë shpirtërore e thellë dhe nga një reflektim teologjik i hapur dhe dialogues.

Kinemaja muzikore e Samuele Bersani-t.

Samuele Bersani i rikthehet skenës pas 7 viteve me albumin e titulluar "Kinemaja Samuel: 10 copëza muzikore në të cilat këngëtari përshkruan, nga pikëvështrimi i tij poetik dhe ironik, botën bashkëkohore, me frikërat e veta, fobitë dhe gjërat e bukura.

Mes gjurmëve gjejmë "rrëshqitje vertikale, një

këgë ironike mbi ndërhyrjen dhe varësinë ndaj internetit, në jetën njerëzore. Vetë titulli tregon mundësinë për të rrëshqitur përmes touch screen ose përmes mousit: porosi tashmë të mësuara, e mbi të gjitha, të pafundme, sikur të mos kishte kurrë një fund në shfletimin e faqeve ueb.

Nxitja nga kënga shtyn në një reflektin mbi vetveten e mbi atë se ku jetohej: "Përse nuk i kushtoj rëndësi se ku jam/madje përplasem/ duke humbur kështu atë çfarë kam."

Duket që nuk e kemi më mundësinë që të jetojmë këtu dhe tani, pasi jemi të përfshirë komplet nga një realitet i ri, që i privohet dimensionit hapësirë e përkohshme. Mbase përgjatë izolimit u perceptua më shumë; pasi duke qenë të detyruar e ashtu siç thotë Bersani: "Nuk vlen më shumë se ajo çfarë unë them." Tastiera dhe ekrani janë bërë ekzistenciale për trupin tonë dhe shikimi është bërë në simbiozë me atë që shikohet në ekran. Realiteti tashmë është filtruar dhe jetuar përmes dispozitivëve teknologjikë. Pyetja përmes këngës: "Që kur nuk më sheh me qafën drejt?" na sjell drejt e në të vërtetën e ekzistencës, e cila është lidhja njerëzore, qoftë fizike a shpirtërore.

Përmes një gjuhe ironike Bersani tregon rëndësinë e eksperiencës direkte, e jo vetëm intelektuale. "Jam rritur me këshillën: e një pediatri pa fëmijë". Jeta është vetëm një shfletosje fletësh, fotosh, lajmesh? Mjafton që të përdorim të gjithë informacionet që teknologjia e bën të mundur që të themi se kemi jetuar në një ekzistencë të veten?

Kinemaja dramatike Ati Ynë, e shkruar nga Mariano Iacobellis S.I

Ati Ynë është filmi artistik i tretë i Claudio Noce, që ka për protagonist Pierfrancesco Favino, fitues i "Copa Volpi" si interpretuesi më i mirë mashkullor, në festivalin e Kinemasë së Venecias. Regjisori rrëfen vetveten kur ishte i vogël, bir i nënkomisarit të Romës Alfonso Noce, viktimë e një atentati nga ana e organizimit terrorist NAP, në të cilën e humbën jetën një polic dhe një kriminel. Megjithatë këto vite qëndrojnë në sfondin e rrëfimit, në një prerje të gazetës, një fragment të lajmeve, një kërkesë e dëgjuar në telefon; pikëvështrimi është ai i syve të ëmbël të Valerios, i interpretuar fort bukur nga Mattia Garaci-, që e vëzhgojnë në mënyrë lakmitare prezencën e prindërve. Barku i tij mëson që të frymojë me një zë, së bashku me barkun e babait dhe mungesa e tij është zgjidhur si rezultat i lidhjes me Kristianin, shok dhe vëlla zëvendësues,

mbase rival apo armik, ku mund të imagjinojmë që të krijohet një dhimbje e fortë, e kundërt por e njëjtë.

Ati ynë është një film ambivalent mbi vetminë dhe tragjedinë që e kanë jetuar familje të tëra; ajo frika që ke se mund të shikosh të vrarë një familjar tëndin, babanë, mamanë, djalnë, vajzën, vëllain apo motrën. Viktimat janë fëmijët, edhe ato të terroristëve: fëmijët e paguajnë fajin e trashëguar nga prindërit.

Në mënyrë fatale, shumë shpesh të “Ati Ynë”, imazhet janë të tepërta, sikur regjisori të mos kishte vetëdije të matjes, në të cilën një çështje personale mund të bëhet universale në film duken shenjat e një dashurie të fshehtë e të një dhimbjeje të fortë, por tregimi jepet në shumë forma, tepër zgjidhje, për të qenë dhe ajo absolute

Letërsi romani, Kolibri – Diego Mattesi S.I.

Sandro Veronesi me romanin *Colibri* ka marrë çmimin “Shtriga 2020”, për herë të dytë pasi e kishte fituar edhe një herë në vitin 2006 me “*Caos Calmo*”.

Sa dhimbje mund të durojë një burrë? Sa prova mund ta detyrojnë atë që t’ia nisin nga fillimi? Historia e Marco Carrera, mjek i okulistikës, ka të bëjë me një seri mjerimesh dhe dhimbjesh, që e shënjojnë në lidhjet me të afërta. Që nga fëmijëria e deri në vdekje i ndjekim ngjarjet në këtë roman me një strukturë të rafinuar, në shumë zëra, të formuar nga fragmente, letra, kujtime, lista, telefonata para dhe pas në kohë. Rrjeti i kujtimeve dhe takimeve, që Veronesi kërkonte që t’ia hiqte tërësisë së jetës së Marcos, na lejon të bëjmë një shikim të brendshëm, ndonjëherë si me turp, pasi nga jeta na kthen misterin dhe momentet që në realitet formojnë zhvillimin ekzistencës.

Kolibri dhe Marco. Zogu i vogël e i shkathët, është pseudonimi që nëna ka zgjedhur për të birin, i cili lufton për t’u zgjatur, akoma i dobët aq sa bashkëmoshatarët e tij, e kalojnë me disa centimetra; bëhet pastaj emri totem, që do ta shoqërojë përgjatë të gjithë jetës. Pasi kolibri është edhe imazhi i luftëtarit, që ka treguar vlera dhe kurajë, duke vdekur në luftë. Por është vetëm një fluturues i vogël, i cili përdor të gjithë forcën e tij, për të rrahur krahët për të qëndruar në një vend, pezull në të njëjtin vend në ajër, pa avancime apo ndryshime: kjo që Marco jeton, është palëvizshmëria apo qëndrueshmëria?

Një roman i pasur me thirrje, i përbërë nga stile të ndryshme shkrimi, Kolibri është një provë e profesionalizmit stilistik, dhe të një zotësie të

madhe kompozicionale. Duke lëvizur para dhe pas në kohë, kolibri duket se është frymëzuar nga vetë forma e romanit, pasi zhvillimi i jetës së Marcos, përmes duarve eksperte të Sandro Veronesi, ka lëvizje tipike të çrregullt të fluturuesit, që lëviz drejt, pas, diagonalisht dhe vertikalisht në mënyrë të padukshme. Këshillohet që të shikohet për atë që pyet se cili është emri i tij totem.

Arte Graphic Novel, Toka, qielli, korbat – Leonardo Vezzani S.I.

Teresa Adice dhe Stefano Turconi përgjatë viteve kanë treguar që ishin të zotë që të tregojnë histori të tëra duke përdorur shumë stile grafike dhe lloje anësore të ndryshme. Në këtë grafik-novelë, të mësuar përgjatë fshatit të Rusisë, një ushtar gjerman, Fuchs dhe një italian, Attilio Limonta, arratisen nga burgu rus dhe marrin peng Vanjën, një roje që e kanë takuar përgjatë arratisjes.

Toka, qielli, korbat nuk është thjeshtë titulli i volumit, por edhe korniza në të cilën përfshihet udhëtimi i protagonistëve. Ato nuk kanë shumë gjëra përreth tyre, përveç një natyre të errët, të egër dhe të heshtur, në një izolim të botës që e detyron të mos mund t’ia mbath as nga vetvetja, as nga lufta dhe nga dhuna, që shfaqet në çdo fletë. I njëjti izolim perceptohet dhe në të pasurit vështirësi në komunikim, duke qenë se tre personazhet flasin gjuhë të ndryshme.

Kjo mungesë e komunikimit, është jetuar edhe nga lexuesi falë mundësisë për të prezantuar dialogje në gjuhën e atij që flet, duke mos e përkthyer, kështu që duke e lexuar jetohet i njëjti zhgënjim, që të tre personazhet e perceptojnë, në atë që flasin pa kuptuar, e në atë që dëgjojnë, por pa marrë vesh.

Ky izolim është pikërisht ajo që bën që të te personazhet zhvishen ndaj kategorive përmes të cilave secili nga to e sheh botën: armiq dhe aleatë, vlerësim dhe dënim, atdhe dhe sakrificë- këto bëhen fjalë pa kuptim. Por është pikërisht kjo pikë që ato mund të takohen, në njerëzoren e tyre të pastër. Për një moment të vetëm ama. E megjithatë ai çast shënon një ndryshim radikal në jetën e të treve.

Toka, qielli, korbat është një novelë grafike ku teksti dhe vizatimet integrohen me ekuilibra të mëdhenj dhe vihet njëri në shërbim të tjetrit, në një histori që nuk mund t’u tregonte me asnjë mënyrë tjetër.

A mund ta shpresojmë të ardhmen pa besim? Giandomenico Mucci S.I.

Sabino Cassese ka shkruar: “Kalëro errësirën”. Zhdukët perëndimi. Jemi bërë të gjithë racistë apo nacionalistë. Fatet ndahen. Njeriu i rrëshqet kufijve. Përhapet një ndjenjë e papërgjegjshmërisë. Shoqëria shpërndahet në mijëra gropa, nuk ka më hapësira për objektiva të përbashkëta. Mirëqenia, solidariteti, e drejta e njeriut tërhiqen. Demokracia dobësohet. Liderët e rinj prezantojnë oferta politike autoritare. Ndahet nga e kaluara dhe kujtimi i luftës shumohet. Theksimi i kërcënimeve shkakton dëshirën e rregullave të forta dhe dënimeve ndaj devijimeve dhe shtyn që të lidhet fort me kulturën e veta.

Dhe vazhdon: “Ndryshime teknologjike, kriza ekonomike, globalizimi kanë prodhuar një gamë të madhe shtetesh, krahinash, profesioneve dhe individësh. Ndryshimi është një motomë e thellë në pabarazinë, pasi i referohet mbrojtjes së vetvetes për të ardhmen e tij. Shtetet e kanë përkeqësuar situatën duke përdorur strategji që kanë spostuar kushtet politike fiskale; e për t’i kaluar ndryshimet duhet shumë kohë. Evropa veçanërisht është shumë e prekshme nga ky fenomen.

Kuadri është pak a shumë i errët dhe aty-këtu na çon në mendje disa analiza si të Huizinga, Ortega y Gasset. Analiza janë bërë edhe në kohën tonë, por mungojnë aspekte pozitive.

Pavarësisht të lindurit nacionalistë, jetojmë në një 70-vjeçar të një Evrope paqësore, edhe zgjatja e jetës rritet. Tensioni social dhe intrigat që shoqërive të shtetit i bënin të kishin dyshime (terrorizëm, përpjekje për grup shteti), nuk janë përsëritur në vitet e fundit. Pjesëmarrja politike, edhe pse duke ulur, nuk zbrit poshtë asaj të qyteteve të tjera evropiane. Dobësitë e shteteve janë konspensuar nga trupat paralele. Shoqëria, derisa kaluan frikërat dhe shqetësimet, është e qetë tani. Nëse të rriturve nuk i hapet një e ardhme rrezatuese, atë e konpesojnë familjet. Globalizmi, nëse në një pikë tërhiqet, zhvillohet në të tjera. Pësia e debitit publik është tjetër, por ka qenë edhe gjithnjë në historinë e zhvillimit italian. Nëse nuk është ëndrra e një jete të bukur, siç është Rilindja, nuk ka humbur shpresa për ta rregulluar botën.

Vendi i Zotit

Analizat dhe shqetësimet që lidhen me të ardhmen sipas eseistëve bashkëkohorë, i referohen gjithnjë anës ekonomike dhe shoqërore. Konteksti filozofik modern dhe bashkëkohorë, shënjohe muzgu e rënë mbi ndërgjegjen e njerëzve, si të jenë zaptuar nga absolutizmi i së vërtetës dhe perandorë të së mirës. “Njeriu është ai çfarë ha”-pohon

Feuerbach. Mendimi korrent, edhe kur është praktikuar nga autorë të një vlere të madhe kulturore dhe profesionale, është karakterizuar nga borxhi i bërë në të kaluarën me humanizmin marksist-komunist, që janë pasuesit e idesë së Zotit, duke zbritur nga vlera e madhe e demonstrimeve të vërteta që lidhen me bashkëbisedimin mbi të. Kriza aktuale e kostumit (të tjerë do të thoshin se liria aktuale e çdo kampi) varet nga dëshira për të ndërtuar jetën dhe shoqërinë e njerëzve, duke u nisur nga vetë Zoti. Kur mohimi i tij nuk është frontal, vihet krejtësisht në funksion të njerëzores të njeriut. Sot, në fakt, kur e mohojnë apo e injorojnë Zotin, e afirmojnë se e bëjnë për të ruajtur realitetin e plotë të njeriut.

Një teolog, i cili ishte një njohës i thellë i mendimit modern, pyeste: Çfarë është njeriu? Dimension i drejtim të transhendentit, është struktura e besimtarit, a janë apo jo pjesë e të qenit të tyre?

T’i mohosh apo vetëm t’i injorosh dimensionet e tilla, e për ta vënë në liri njeriu autentik, apo është shkurtuar dhe mbytur ai? Doktrina katolike afirmon se një prizëm human ndaj njeriut, është i zoti që të promovojë njeriun integral, dhe pafundësisht një humanizëm besimtarë. Mendja njerëzore, na tregon Vatikani I dhe II, është i hapur ndaj misterit të Zotit, si një princip i parë dhe mbi të vërtetën e çdo gjëje.

Pas profilin praktik, duhet t’i kushtojmë rëndësi kardinalit Angelo Scola, teksa fliste mbi besime si një realitet vital, që është i aftë për të zhvilluar një subjektivitet publik tepër të komentuar: “Në këtë realitet shekullorë në të cilën, së bashku me modernizmin, është shtuar referimi ndaj Zotit, në kuptimin e një ecjeje, duhet theksuar se të gjithë përpjekjet e bëra për ta zëvendësuar kanë dështuar. Mjafton që të bëhet diskutimi i rënies së rrëfimeve të mëdha”.

Kur mendojmë për të ardhmen, besimtari beson dhe shpreh një premtim, i cili pushon mbi premtimet dhe lavdinë e Zotit në besimin e krishterë. Dhe kur i reflektohet zhvillimit të historisë dhe të mendimit njerëzorë, mbi elementet e historisë e mbi rezultatet dhe heshtjeve të mendimit, thërritet në mendje dhe mbështetet ajo çka Kant i shkroi njeriut, që është një dru kaq i shtrembër, me anë të së cilës nuk mund të ndërtohet asnjë gjë që është në një drejtësi perfekte.

Përktheu: **Bernardina Shahini**

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “*La civiltà cattolica*”, 2020.

“ORIENTIMET PASTORALE MBI TRAFIKIMIN NJERËZOR”

*Dita Botërore e Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit njerëzor
8 shkurt 2021*

Kujtimi liturgjik i Shën Jozefina Bakhitës

Zhvillohet konferenca kombëtare: “Besimet fetare kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore në Shqipëri” Ditën e hënë me datë 8 shkurt 2021, Caritasi Shqiptar në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë kanë organizuar konferencën kombëtare: Besimet fetare kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore në Shqipëri, zhvilluar në sallën e konferencave të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë.

Seksioni Emigrantët dhe Refugjatët të Dikasterit për Shërbimin e Zhvillimit Njerëzor Integral e ka pritur me entuziazëm eventin që mbahet sot në Tiranë me rastin e Ditës Botërore të Lutjes dhe të Reflektimit kundër Trafikimit të Personave dhe publikimin e Orientimeve Pastorale mbi trafikimin e qenieve njerëzore në gjuhën shqipe.

Seksioni Emigrantët dhe Refugjatët është një organizëm që na siguron mbështetje në Shqipëri për aktivitetet që zhvillojmë në favor të zhvillimit njerëzor integral të emigrantëve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe viktimave të trafikimit.

Do të prezantoj shkurtimisht këtë dokument duke bërë pak histori dhe rekomandimet që na jep Papa Françesku.

* * *

Në shtator të 2015, Ati i Shenjtë, duke iu drejtuar Kombeve të Bashkuara, thoshte që të këqijat si “trafikimi i qenieve njerëzore, tregtia e organeve njerëzore, shfrytëzimi seksual i fëmijëve, puna e skllavëruar, duke përfshirë prostitucionin, trafikimin e drogës dhe të armëve, terrorizimin dhe krimin ndërkombëtar të organizuar” nuk mund të përballohen vetëm me “angazhime të ndërmarra në mënyrë solemne.” “Duhet të tregojmë kujdes që institucionet tona” - dhe me siguri të gjitha përpjekjet tona - “të jenë me të vërtetë efikase në luftën kundër të gjitha këtyre plagëve.”

Në letrën enciklike *Fratelli Tutti*, Papa Françesku thekson se “pavarësisht se komuniteti ndërkombëtar ka miratuar marrëveshje të shumta me qëllimin për t'i dhënë fund skllavërisë në të gjitha format dhe ndërmarrë strategji të ndryshme për të luftuar këtë fenomen, akoma sot miliona njerëz - fëmijë, burra e gra të çdo moshe - privohen nga liria dhe janë të detyruar të jetojnë në kushte skllavërie. [...] Sot sikur dje, në rrënjën e skllavërisë gjendet një koncept që pranon mundësinë e trajtimit të



qenieve njerëzore si një objekt. [...] Qenia njerëzore, e krijuar në imazhin dhe përngjasimin e Zotit, me forcën, mashtrimin ose me detyrimin fizik apo psikologjik privohet nga liria, kthehet në objekt, reduktohet në një pronë të dikujt; trajtohet si një mjet dhe jo si një qëllim”.

Orientimet Pastorale mbi trafikimin njerëzor

Për t'u përballur me problemin e trafikimit dhe të skllavërisë së qenieve njerëzore, gjatë 2018, Seksioni M&R ka organizuar dy konsulta me ipeshkvij, koordinatorë pastoralë, studiues, operatorë profesionistë dhe përfaqësues të organizmave të në këtë sektor. Pjesëmarrësit kanë shkëmbyer eksperiencë dhe pikëpamje, duke përballuar aspektet përkatëse të fenomenit. Gjithashtu, është analizuar një përgjigje globale e Kishës, duke specifikuar të gjitha pikat e forta dhe dobësitë, mundësitë politike dhe pastorale, ashtu si edhe nevoja e fuqizimit të koordinimit në nivel botëror.

Ky proces, që ka zgjatur gjashtë muaj, i ka dhënë jetë *Orientimeve Pastorale mbi trafikimin njerëzor*, të cilët, të aprovuar nga Ati i Shenjtë, propozojnë të orientojnë punën e Seksionit M&R dhe të bashkëpunëtorëve të tij. *Orientimet* i drejtohen dioqezave, famullive dhe kongregatave fetare, shkollave dhe universiteteve, organizatave katolike dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile

dhe të çdo lloj grupi tjetër i gatshëm për t'u impenjuar në këtë fushë. Përveç se furnizojnë linja veprimi në nivel lokal dhe bashkëpunimi në distancë, *Orientimet* ofrojnë edhe shtysa për homeli, programe trajnimi dhe komunikimi mediatik.

Për më tepër, “dokumenti përqendrohet mbi njeriun, duke theksuar jo vetëm dramën e viktimave, por edhe efektin e dëmshëm që mëkati i trafikimit të qenieve njerëzore ka mbi njerëzimin dhe mbi dinjitetin e atyre që kërkojnë të përfitojnë nga ky akt mizor, një realitet që shpesh nuk konsiderohet.”

Orientimet Pastorale kanë rrënjë të thella në reflektimin dhe në mësimdhënien e Kishës dhe të eksperiencës së saj të gjerë praktike në të përgjigjurit të nevojave të burrave, grave, djemve dhe vajzave viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të skllavërisë, qoftë në të kaluarën, edhe në të tashmen.

Në Këshillin Vatikani II, Kisha Katolike ka ripohuar shqetësimin e saj historik mbi punën e detyruar, duke thënë se “skllavëria, prostitucioni, tregu i grave dhe i të rinjve, ose akoma kushtet e punës të përçmueshme, me të cilat punëtorët trajtohen thjesht si mjete përfitimi, dhe jo si persona të lirë dhe të përgjegjshëm [...] janë sigurisht të turpshme.” Tani “Kisha Katolike ka për qëllim të ndërhyjë në çdo fazë të trafikimit të qenieve njerëzore” thotë Papa Françesko; “do t'i mbrojë nga mashtrimi dhe nga joshja; do t'i gjejë dhe t'i lirojë kur transportohen dhe reduktohen në skllavëri; do t'i ndihmojë sapo të çlirohen.”

Mësimet e vendosura të Papa Françeskut mbi trafikimin njerëzor ofrojnë themelin për këto *Orientime Pastorale*. Këto janë aprovuar nga Ati i Shenjtë, që dëshiron të promovojë “koordinimin e iniciativave të ndryshme pastorale, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Zyrtar përgjegjës të Kishave lokale, kongregatat fetare dhe organizatat katolike janë të thirrura për të bashkëndarë eksperiencën dhe dije dhe për të bashkuar forcat e tyre, në një veprim sinergjik që ka si interes Vendet e origjinës, tranzitin dhe destinacionin e personave që janë objekt i trafikimit.”

Orientimet nuk pretendojnë që të trajtojnë të gjitha mësimet e Kishës mbi trafikimin e personave; ato mbi të gjitha ofrojnë një sërë konsideratash esenciale, në projektimin dhe në angazhimin konkret, në advokaci dhe në dialog.

Struktura e dokumentit është shumë e thjeshtë. Pas marrjes në konsideratë të përkufizimit juridik të trafikimit njerëzor të propozuar nga ligji



ndërkombëtar, secila nga dhjetë seksionet e *Orientimeve* analizon realitetin mizor dhe vështirësitë e veta të aspekteve të ndryshme të fenomenit. Sugjerohen, kështu, një sërë përgjigjesh, për t'u marrë në konsideratë urgjente nga çdo individ dhe institucion me vullnet të mirë.

Orientimet identifikojnë 10 çështje me përparësi të cilave Kisha është e thirrur që t'u përgjigjet: 1) Shndërrimin e njeriut në mall dhe shfrytëzimin e tij; 2) kërkesa e shoqërisë për të “konsumuar” trafikimin; 3) ngurrimi për të njohur trafikimin njerëzor si fenomen; 4) identifikimi dhe denoncimi i trafikimit njerëzor; 5) lidhja midis trafikimit dhe botës së biznesit 6) kushtet e punës dhe zinxhirët e furnizimit; 7) Trafikimi i personave dhe kontrabandimi i emigrantëve në veçanti; 8) përforsimi i bashkëpunimit 9) mbështetja i të mbijetuarve të trafikimit; dhe 10) promovimi i riintegrit.

Duhet të hapim sytë ndaj fenomenit të trafikimit njerëzor, një fenomen i përhapur dhe shpesh i padukshëm, dhe këto *Orientime* na ndihmojnë për të kuptuar se si të veprojmë. Trafikimi njerëzor është një problem shumë kompleks për shkak të varietetit në format e tij, nga heterogjinia e viktimave të saj dhe diversiteti i tipologjive të praktikuesve të tij. Ata që duan të projektojnë shërbime efikase menjëherë hasin sfida domethënëse. Një kompleksitet i tillë kërkon zbatimin e një qasjeje shumëdisiplinare me qëllim kuptimin e fenomenit dhe të shkaqeve të tij, identifikimin e proceseve dhe të personave të përfshirë, para se të kalohet në formulimin e përgjigjeve të përshtatshme.

Dëshiroj kështu të përfundoj këtë kontributin tim me fjalët e Atit të Shenjtë: “Është bërë dhe po bëhet shumë, por shumë ngelet akoma për t'u bërë. [...] Për ta bërë më të përshtatshme dhe efikase veprimin e saj, Kisha duhet të dijë të përdorë ndihmën e aktorëve të tjerë politikë dhe socialë. Nënshkrimi i bashkëpunimeve të strukturuar me institucionet dhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile do të jetë garancia e rezultateve më të prekshme dhe të qëndrueshme.”

ZHVILLIMI TËRËSOR NJERËZOR DHE MBROJTJA E KRIJIMIT

Dy webinar-e për përkujdesen shoqërore dhe baritor të krijimit dhe të shoqërisë

Komisioni Baritor Social i Këshillit të Konferencave Ipeshkvore Evropiane (KKIE)

Me datat 3 dhe 10 shkurt 2021 janë zhvilluar dy webinar-e të organizuara nga Komisioni Social Baritor i KKIE-së mbi çështjet aktuale të zhvillimit e të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të mbrojtjes së krijimit.

Dy webinar-et kanë zëvendësuar simpoziumin që ishte planifikuar të zhvillohej në mes të marsit 2020 në Shkodër, Shqipëri, por i cili u anulua për shkak të pandemisë.

Seminari i parë, ku morën pjesën 45 ekspertë dhe delegatë nga Konferenca të ndryshme Ipeshkvore Evropiane dhe organe kishtarë që punojnë në fushën sociale, filloi me përshëndetjet e Presidentit të Komisionit, Shkëlqesisë së Tij Imzot Giampaolo Crepaldi-t, dhe të Përgjegjësit të Seksionit për Mbrojtjen e Krijimit të këtij Komisioni, Shkëlqesisë së Tij Imzot Angelo Massafra-s O.F.M.

mbi nevojën e kalimit në një ekonomi rrethore, e cila modifikon kriteret e prodhimit dhe synon një përdorim të përshtatshëm të energjisë së rinovueshme. Në këtë këndvështrim - tha Prof. Civici - është e nevojshme që të bëhet një reflektim etik më i thellë mbi marrëdhëniet e njeriut me natyrën.

Seminari i parë u mbyll me reflektimin dhe lutjen e Kardinal Angelo Bagnasco-s, President i KKIE-së, i cili theksoi rëndësinë e angazhimit të besimtarëve në sferën sociale dhe në ruajtjen e krijimit, jo vetëm për arsye etike, por thelbësisht sepse kjo gjë i përgjigjet vetë natyrës së të besuarit.

Në seminarin e dytë, më 10 shkurt, relatorët prezantuan: një model për ta mbrojtur krijimin, duke folur për *"Reformën Agrare"* bërë nga Italia pas Luftës së Dytë Botërore, relator Dr. Nunzio Primavera, Gazetar dhe



Ndërhyrja e parë, e titulluar *"Magjisteri i Papa Françesku mbi zhvillimin tërësor njerëzor dhe ruajtjen e krijimit"*, iu besua Imzot Dario Edoardo Viganò-së, Zëvendës-Kancelar i Akademisë Papnore të Shkencave dhe i Akademisë Papnore të Shkencave Sociale (Vatikan). Në fjalën e Tij, Imzot Viganò-ja theksoi se, meqenëse Doktrina Shoqërore është rrjedhojë e vetë misionit të Kishës, Papa Françesku, në mendimin e tij shoqëror, lidh fenë në Krishtin me përvojën e dashurisë së Kishës. *"Kisha - pohoi ai - nuk mund të dojë veçse sipas mënyrës së Krishtit"*. Prandaj, angazhimi i Kishës - siç ka pohuar shumë herë Papa Françesku - nuk kërkon që t'i gjejë të gjitha përgjigjet e problemeve të njerëzimit, por të ndihmojë në gjetjen e përgjigjeve dhe në marrjen e vendimeve të frymëzuara prej Ungjillit.

Ndërhyrja e dytë, e titulluar *"Sfidat mjedisore të paraqitura nga disa modele të zhvillimit ekonomik"*, u prezantua nga Prof. Adrian Civici, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Qasja dhe pasojat e formave aktuale të konsumizmit qenë pika fillestare e reflektimit të folësit, i cili më pas këmbënguli

Shkrimtar (i Coldiretti-t); *"Promovimi i zhvillimit dhe i mbrojtjes së mjedisit në projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar të lidhura me bujqësinë"*, relator Dr. Maurizio Reale, Zëvendës-President i Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (Bruksel); dhe në fund *"Perspektiva zhvillimi agro-industrial dhe përfshirja e të rinjve"* relatore Dr. Veronica Barbat, Presidente Kombëtare e organizatës *"Giovani Impresa"* (Coldiretti).

Pas një debati interesant Imzot Angelo Massafra falënderoi relatorët, të gjithë pjesëmarrësit, Ipeshkvijtë, priftërinjtë dhe të rinjtë e shumë, si dhe bashkëndau me të pranishmit shpresën e Tij që një reformë e mirë agrare të bëhej edhe në Shqipëri, për t'i stimuluar shqiptarët që ta punojnë tokën *"Nënë"* dhe që të mos e braktisin atdheun e tyre. Takimi u mbyll me një lutje drejtuar Shën Jozefit, Pajtorit të Punëtorëve. *Pjesëmarrës në webinar-e*

Luigj Mila

Pjesëmarrës në webinar-e

DO TË ANGAZHOHEMI NË VEPRA KONKRETE BAMIRËSIE

Lutja për Bashkimin e të Krishterëve

Me datën 18 janar 2021 në orën 16.00 u kremtua lutja e mbrëmësore në kishën e Shën Françeskut në Gjuhadol me rastin e javës së lutjes për bashkimin e të krishterëve që zhvillohet nga data 18 deri me datën 25 janar të çdo viti. Lutjen e mbrëmësore e udhëhoqi shkëlqesia e tij Imzot Angelo Massafra Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit. Lutja e mbrëmësore filloi me një këngë të kënduar nga besimtarët dhe menjëherë Arqipeshkëvi shpjegoi se jemi të mbledhur për të bërë atë që na ka porositur Jezusi të lutemi që të gjithë të jenë një sikurse Ai dhe Ati janë një. Pastaj si gjithmonë lutja vazhdoi me shpjegimin, përmbajtjen dhe me informacionin se kush e ka përgatitur javën e lutjes për bashkimin e të krishterëve për këtë vit. Në vazhdim u ndoq riti që ishte përgatitur nga zyra ekumenike dhe e marrëdhënieve ndërfitare ku në mes të kësaj liturgjie pas leximit të ungjillit imzot Angelo shpjegoi pjesën e ungjillit dhe ndër të tjera përmendi edhe dy figurat e mëdha të ekumenizmit që janë Patriarku i Stambollit (Konstantinopojës) Atenagora dhe Papën Palin e VI që u takuan në Jerusalem në datat 5 e 6 janar 1964 dhe hoqën mallkimet që kishat ia kishin dërguar njëra tjetrës në vitin e largët 1054.

Po ashtu pas homelisë së Imzot Angelos bëri një përshëndetje të shkurtë edhe Famullitari i famullisë ortodokse të Lindjes së Krishtit në Shkodër Atë Nikolla Petani. Ndër të tjera kujtoi besimtarët që

kanë vdekur gjatë vitit që kaloi për shkak të Pandemisë Koronavirus. Ungjilli i ditës tha ai na fton të shkojmë pas Jezusit për të qenë nxënësit e tij dhe për të qëndruar me të, dhe e mbylli përshëndetjen duke uruar që sa më parë të mund të kremtojmë eukaristinë së bashku sepse një është Zoti Krisht dhe nuk mund të ndahet në kisha të ndryshme por duhet të bashkohemi e të kremtojmë eukaristinë ashtu sikurse e kemi kremtuar në fillim duke qenë të bashkuar.

Ndërsa me datën 20 janar 2021 në orën 16.00 u kremtua lutja e mbrëmësore në kishën ortodokse të Lindjes së Krishtit në ritin bizantin të kryesuar nga Atë Nikolla Petani dhe i ndihmuar në këtë kremtim nga Atë Ivan Popaj.

Atë Nikolla në fillim të liturgjisë dha mirëseardhjen dhe pas leximit të Ungjillit bëri një reflektim mbi pjesën e Ungjillit të Shën Gjonit kapitulli 13 rreshtat 1-15, 34-35. Kemi patur tha ai një hap të rëndësishëm ashtu si e ka theksuar edhe Imzot Massafra në dy figurat e mëdha të ekumenizmit Patriarkun Atenagora dhe Papën Palin e VI. Edhe në Ungjillin e sotshëm tha ai Zoti na thotë se erdha të shërbej. Perëndia vjen në tokë dhe shërben duke u larë këmbët Apostujve. Zoti ka një plan për ne e plani i Tij është që të jemi të gjithë së bashku, plani i Zotit është që të lutemi për bashkimin e Kishave. Nuk është mirë që ne ti kthehemi gjërave të vjetra duke thënë se unë nuk



kam faj por e ka ai fajin, sepse tek e fundit të gjithë jemi fajtor sepse nuk lutemi me gjithë zemër. Nëse ne themi jam katolik i mirë, lavdi Zotit ose nëse themi jam ortodoks i mirë përsëri lavdi Zotit por ne duhet të arrijmë që të themi të gjithë së bashku jam i krishterë i mirë. Besimtarët tanë kanë turp të thonë se jam i krishterë, po pse duhet të kemi turp të dëshmojmë Zotin. Në Shkodër kemi shumë shembuj të mirë në martirët të cilët para vdekjes thanë rroftë Krishti, po ne çfarë dëshmie japim. Pas homelisë së tij Atë Nikolla ftoi Imzot Angelon që të bëjë përshëndetjen e rastit.

Imzot Angelo falënderoj Atë Nikollën dhe P. Landin, Përgjegjës i Zyrës Dioqezane për këto dite lutjeje, që është tashmë zakon të takohemi në janar për lutjen për bashkimin e të krishterëve; lutja është arma jonë. Në ungjill kemi dëgjuar se Jezusi ka thënë: “i deshi deri në fund” dhe “qëndroni në dashurinë time”, për këtë të gjithë të krishterët, katolikë, ortodoksë dhe protestantë do të angazhohemi në vepra konkrete bamirësie.

Edhe Papët si Gjon Pali i II, Benedikti XVI si edhe Papa Françesku kanë thënë se ekziston një ekumenizëm i b a m i r ë s i s ë , një ekumenizëm i dialogut dhe i

martirizimit, sepse sot shumë të krishterë janë persekutuar dhe vrarë për Krishtin dhe në të ardhmen, kur do Zoti, do të kemi ekumenizmin edhe në nivel teologjik, kur të tejkalojmë problemet teologjike që pengojnë sot bashkimin e të krishterëve. Na ndihmofshin në këtë ecje Zoja e Bekuar, Shën Pali e Shenjtërit e tjerë që të arrijmë këtë bashkim të krishterëve.

Në fund një falënderim grupit vullnetar të “Shoqatës Malteser” sepse te Kisha e Shën Françeskut edhe te Kisha Ortodokse ishin të pranishëm për të ndihmuar në dizinfektimin e duarve të besimtarëve dhe në dhënjën e maskave atyre që nuk i kishin marrë me vete.

Fr. Landi Jaku OFM



GJITHMONË I GATSHËM PËR TË NDIHMUAR TË TJERËT

25 vjetori i vdekjes së Mons. Loro Nodaj

Me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së Mons. Loro Nodaj më 17.01.2021 në Kishën “Zemra e Krishtit” Guri i Zi u celebrua mesha e shenjte e udhëhequr nga Imzot Angelo Massafra në bashkë celebrim me Dom Raffaele Gagliardi për të përkujtuar e nderuar këtë figurë të rëndësishme për fshatin tonë, për Shkodrën dhe për gjithë Kishën e Shqipërisë.

Në hyrje të meshës Dom Raffaele tregoi shkurtimisht historinë e jetës së MonsinJORIT.

Dom Loro Nodaj lindi më 11.05.1918 në fshatin Guri i Zi, fare pranë Shkodrës. Mësimet e para i kreu në vendlindje, ndërsa të mesmet në Kolegjin Saveriane ku aty dëgjoj thirrjen për t'ia kushtuar jetën Zotit. Mësimet e mesme i përfundoi me sukses, ku pastaj u nis për Romë. Studimet e larta i kreu në Universitetin Papnor *Urbaniano*. Meshën e parë e celebroi në vitin 1941. Më pas shërbeu si famullitar në Mal Kolaj. Shpejt nisi të merrej edhe me letërsi artistike. Shkroi tregime e publicistika me tema të ndryshme, fetare e atdhetare, ku i botoi në revistën e dioqezës së Shkodrës “Kumbona e së Dielës” me pseudonimin 'Lodja'. Në vitin 1947 u detyrua të kryente Shërbimin Ushtarak në Repartin e tmerrshëm të Punës. Më 5 korrik 1949 u arrestua dhe u dënua me 15 vite burgim me akuzën 'për agjitacion e propagandë'. Kishte mundësi që të mos dënohej nëse bënte atë çfarë i thoshte sigurimi i asaj kohe, por ai me force e guxim tha: “Një ditë i'a kam dhanë besën Zotit dhe atij do t'i shërbej deri në çastin e fundit të jetës”. U lirua në shtator të vitit 1961, ku fill nisi punën si punëtor në Kooperativën bujqësore të Gurit të Zi. Gjatë kësaj kohe banoj



pranë familjes. Vijoi të shkruante në heshtje dëshmitë e martirizimit të Kishës katolike, por nuk janë botuar. Më 1991, kur u hapën Kishat, nisi shërbimin meshtarak në zonën e Velipojës. U caktua famullitar i Katedrales së Shën Shtjefnit në Shkodër. Vdiq më 16.01.1996 ku qe varrosur në fshatin e lindjes.

Në këtë meshë të shenjte morën pjesë familjarë të MonsinJORIT (me shpirt edhe ata që janë larg) si dhe besimtarë të shumtë të kësaj famullie e fshatrave përreth, ku shumë prej tyre kanë punuar e jetuar me të, për ta nderuar e kujtuar si dhe për t'iu lutur atij që tashmë është tek Ati ynë qiellor. Për gjithë popullin e Gurit të Zi (edhe për myslimanët) ai kujtohej si një njeri i përvuajtur, punëtorë e gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar të tjerët. Dom Loro Nodaj gjatë kohës së rrëgjimit komunist ka shërbyer në fshehtësi në gjithë zonën duke kryer të gjitha Sakramentet e shenjta edhe pse vendoste veten e tij në rrezik. Imzot Angelo Massafra na ftoi të gjithëve që ta kujtojmë gjithmonë këtë njeri kaq të përvujt në zemrat tona duke iu lutur atij që të ndërmjetësoj tek Ati që të kemi nga kjo famulli shumë djem e vajza që i shërbejnë Hyjit ashtu si i ka shërbyer ai.

Pas meshës të gjithë së bashku me Imzot Angelo Massafra shkuan tek varri i Mons. Loro Nodaj. Një lutje, lule e shumë nderime për Dom Loron dhe shumë hire e bekime për ne.

Duke përkujtuar Mons. Loro Nodaj të jetë një mundësi për ne ku të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të, i cili shërbej dhe dha jetën për ne. Por edhe mundësia për të pyetur veten tonë nëse jemi duke ecur në gjurmët e tij.

Don Raffaele Gagliardi



MË 28 JANAR 1704 U MIRATUAN DOKUMENTET E KUVENDIT KISHTAR TË ARBËNIT TË VITIT 1703



Në përfundim të punimeve, dekretet e Koncilit të Arbnit, shkruar në shqip e latinisht nga vetë Imzot Zmajeviqi, iu paraqitën për shqyrtim Papës dhe, pas miratimit, më 28 janar 1704, i gjithë teksti i Kuvendit u botua në latinishte nga Kongregata e Vatikanit “Propaganda Fide”, dhe në shqip, në vitin 1706, nën titullin “Kuvendi i Arbnit o Koncili Provinciali i mbledhun Vjetit mijë shtaqind e tre ndenë Shqiptarin Klementin XI papë Pretëmadhin”.

Më 28 janar të vitit të largët 1704, Kongregata e atëhershme e Vatikanit, “Propaganda Fide” (Propaganda e Fesë), sot Kongregata për Ungjillëzimin e Popujve, miratonte botimin e dokumenteve të Koncilit të parë kishtar të Arbërit, apo Asamblesë së Parë të klerit katolik shqiptar i të gjitha trojeve, që u mbajt në fshatin Mërçi të qytetit të Lezhës.

Kuvendi apo Koncili kishtar i Arbërit që u mbajt në Kishën e Shën Gjonit të Merçisë, tri kilometra në veri të Lezhës, nën drejtimin e Imzot Vinçenc Zmajeviqit, ishte me rëndësi të jashtëzakonshme për fatet e Kishës katolike në trojet shqiptare, të gjuhës shqipe e të identitetin etnik të kombit shqiptar. Ishte data 14 janar e Kuvendi do të vijonte edhe të më 15 e 16 janar 1703.

Më 28 janar 1704 Kongregata për Ungjillëzimin e Popujve, që njihej me emërtimin latin “Propaganda Fide” miratonte botimin e dokumenteve të këtij Konçili kishtar. Asokohe në fronin e Shën Pjetrit ishte ulur Papa shqiptar, Françesk Albani (Kelmendi XI), i cili i pati kërkuar Imzot Vinçenc Zmajeviqit, Kryepeshkëv i Tivarit, në cilësinë e vizitatorit apostolik, të kryente vizitën kanonike në të gjitha dioqezat, mundësisht edhe kishat e qendrat katolike të Shqipërisë. Pas kësaj vizite apostolike, që e kreu brenda tre muajve, në dhjetor të vitit 1703, kryepeshkvi imzot Zmajeviq mblodhi në Koncil apo Kuvend kishtar: 7 ipeshkvij dhe tre misionarë, nën presidencën e tij, si kryepeshkëv i Tivarit, vizitator apostolik e primat i Serbisë.





IMZOT ERNEST ÇOBA

ARQIPESHK VIA
SHKODËR - PULT, 2021



ORIENTIME BARITORE
KUNDËR TRAFIKIMIT TË
QËNIEVE NJERËZORE

ARQIPESHK VIA
SHKODËR - PULT, 2020



VËLLEZËR
TË GJITHË

ARQIPESHK VIA
SHKODËR - PULT 2021

KUMBONA E SË DIELLËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 100 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIV, nr. 1/2 (539-540) Janar - Shkurt 2021